



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 105 Akti

Nr. 150 Vendimi
Tiranë, më 28.5.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Etleđa Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, në datën 27 maj 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Roland Jaupaj, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në pikën 5, të nenit 3, dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, me funksionin gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “**Komisioni**”), ka hedhur shortin në datën 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. ***, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Etleda Çiftja, dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.3.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, bazuar në kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, bazuar në kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e

deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, bazuar në kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 8.2.2018, e **Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**, me anë të së cilës dërgohet një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 17.10.2018, të KDZH-së), sipas nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj.*

12. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të

gjithanshëm mbi tri kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 7.5.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 8.5.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 17.5.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja me *e-mail-in* e datës 21.5.2019.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 22.5.2019.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.5.2019, ora 10:00, në mjediset e Pallatit e Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Roland Jaupaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e

Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017¹ dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komisioni nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komision;

¹ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD;
- ë) denoncimet e publikut;
- f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe, në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj.

23.2 Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.3 Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

24. Depozitë në “Veneto Bank”², krijuar në datën 31.8.2015, me afat 3 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 800,000 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 %;
- iii. burimi i krijimit: nga depozitat bankare të mëparshme dhe përfitimi i interesave të krijuara; si burim fillestar të ardhurat nga paga si gjyqtar, ato si pedagog në Universitetin “****” për vitet 2010 – 2013.

24.1 Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

24.1.1 “Intesa Sanpaolo Bank”³, si shoqëri përrithëse e “Veneto Bank”, ka dërguar lëvizjet e llogarive të subjektit të rivlerësimit në “Veneto Bank”.

24.1.2 Nga verifikimi i këtyre llogarive konstatohet se:

- i. në datën 29.8.2013, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën prej 800,000 lekësh;
- ii. në datën 29.8.2015, ka përfutur interesat në shumën prej 112,000 lekësh, mbi të cilat është mbajtur tatimi prej 16,800 lekësh;
- iii. në datën 31.8.2015, subjekti ka tërhequr nga kjo llogari shumën prej 95,200 lekësh dhe shumën prej 800,000 lekësh e ka kaluar në depozitën me nr. 21675;

² Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks **** në dosjen e ILDKPKI-së): Kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 31.8.2015 për hapje depozite nga z. Roland Jaupaj, në vlerën 800,000 lekë; data e mbarimit të afatit 31.8.2018.

³ Me shkresën nr. **** prot., datë 22.2.2019.

- iv. në datën 29.8.2018, nga kjo depozitë janë përfituar interesat në shumën prej 73,372 lekësh dhe se shuma totale e saj është transferuar në llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank” me nr. ***.

24.2. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank” (shoqëria përthithëse e “Veneto Bank”), për gjendjen e kësaj pasurie në momentin e deklarimit. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

25. Depozitë në “Veneto Bank”⁴, e çelur në datën 25.8.2014, me afat 3 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 900,000 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 %;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita bankare e mëparshme prej 1,583,700 lekësh bashkë me interesat, të krijuara këto në vite nga depozitat e mëparshme + interesat bankare; si burim fillestar të ardhurat nga paga si gjyqtar, ato si pedagog në Universitetin “****” për vitet 2010 – 2013 dhe interesat bankare të përfituar.

25.1 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri:

25.1.1 “Intesa Sanpaolo Bank”⁵, si shoqëri përthithëse e “Veneto Bank”, ka dërguar lëvizjet e llogarive të subjektit të rivlerësimit në “Veneto Bank”.

25.1.2. Nga verifikimi i këtyre llogarive konstatohet se:

- i. në datën 23.8.2012 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën prej 800,000 lekësh në llogarinë me nr. *** në “Veneto Bank”;
- ii. në datën 23.8.2013 ka përfituar interesat në shumën prej 55,200 lekësh, mbi të cilat është mbajtur tatimi në shumën prej 5,520 lekësh;
- iii. po në datën 23.8.2013:
 - subjekti ka kaluar nga depozita 3-mujore me nr. **, në llogarinë depozitë me nr. *** në “Veneto Bank”, shumën prej 404,083 lekësh (*shumë kjo e krijuar nga shuma prej 400,000 lekësh derdhur cash në datën 23.5.2013 dhe përfitimi i interesave në datën 25.8.2013*); dhe
 - ka depozituar *cash* shumën prej 246,240 lekësh po në këtë llogari. Gjendja e kësaj llogarie në datën 23.8.2013 është në vlerën 1,500,003 lekë;
- iv. në datën 25.8.2014 nga kjo llogari është përfituar interesi në shumën prej 93,000 lekësh, mbi të cilin është mbajtur tatimi në shumën prej 9,300 lekësh dhe gjendja totale e kësaj llogarie depozitë shkon në vlerën 1,583,703 lekë;
- v. po në datën 25.8.2014, nga gjendja e kësaj llogarie shuma prej 683,703 lekësh kalohet te depozita tjetër në emër të subjektit të rivlerësimit në “Veneto Bank” me nr. 17152 dhe *shuma prej 900,000 lekësh kalohet në depozitë me afat 3-vjeçar, në depozitën me nr. **, në “Veneto Bank”*;
- vi. në datën 25.8.2017, nga depozita me nr. *** në “Veneto Bank”, është përfituar interesi në shumën prej 108,098 lekësh, mbi të cilin është mbajtur tatimi në shumën prej 16,215 lekësh;

⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 25.8.2014 për hapje depozite nga z. Roland Jaupaj, në vlerën 900,000 lekë; data e mbarimit të afatit 25.08.2017; dhe (2) urdhër pagesë të shumës prej 900,000 lekësh nga Roland Jaupaj.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019.

vii. në datën 31.8.2017, subjekti i rivlerësimit tërheq *cash* të gjithë vlerën e kësaj depozite, shumën prej 991,883 lekësh.

25.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank” për gjendjen e kësaj pasurie në momentin e deklarimit. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

26. Depozitë në “Veneto Bank”⁶, e çelur në datën 25.8.2016, me afat 3 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 724,328 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 %;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita e mëparshme bankare në vlerën prej 683,700 lekë + përfitimi i interesit me maturimin e depozitës, të lëna sërish në depozitë, të krijuara këto në vite nga depozitat e mëparshme + interesat bankare; burimi fillestar të ardhurat nga paga si gjyqtar dhe ato si pedagog në Universitetin “***”, për periudhën 2010 – 2013.

26.1 Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

26.1.1 “Intesa Sanpaolo Bank”⁷ ka dërguar lëvizjet e llogarive të subjektit të rivlerësimit në “Veneto Bank”.

26.1.2 Nga verifikimi i këtyre llogarive konstatohet se:

- i. siç e kemi evidentuar edhe më sipër, në datën 25.8.2014, nga gjendja e llogarisë nr. *** në “Veneto Bank”, shuma prej 683,703 lekësh kalohet te depozita tjetër me nr. *** në “Veneto Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit, duke krijuar depozitë me afat 2-vjeçar;
- ii. në datën 25.8.2016 nga kjo depozitë janë përfituar interesat në shumën prej 47,794 lekësh dhe është mbajtur tatimi në shumën prej 7,169 lekësh;
- iii. po në datën **25.8.2016, shuma prej 724,328 lekësh** kalohet nga depozita me nr. ***, **te depozita me nr. *****, duke krijuar një depozitë të re me këtë vlerë;
- iv. në datën 29.8.2018 të gjitha fondet e kësaj depozite kanë kaluar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

27. Depozitë në “First Investment Bank”⁸, e çelur në datën 31.8.2015, me afat 2 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 1,083,000 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 %;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita e mëparshme në vlerën prej 988,400 lekësh dhe interesi prej 95,000 lekësh, i përfituar në datën 31.8.2015 nga depozita në “Veneto Bank”, të krijuara këto në vite nga depozitat e mëparshme dhe interesi bankar; me

⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 25.8.2016 për hapje depozite nga z. Roland Jaupaj, në vlerën 724,328 lekë; data e mbarimit të afatit 25.8.2019; dhe (2) urdhërpagesë të shumës prej 724,328 lekësh nga Roland Jaupaj.

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019.

⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Kontratë depozite me “FiBank”, e datës 31.8.2015 për hapje depozite nga z. Roland Jaupaj në vlerën 1,083,000 lekë, me afat 2 vjet; dhe (2) mandatarkëtimet për interesin e përfituar në vlerën 95,000 lekë.

burim fillestar të ardhurat nga puna si gjyqtar dhe ato si pedagog në Universitetin “***” në periudhën 2010 – 2013.

28. Llogaritë rrjedhëse në “First Investment Bank”⁹, vlera prej 30,660 lekësh

28.1 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këto pasuri (llogaritë në “FiBank”)

28.1.1 “First Investment Bank”¹⁰ na informon se subjekti i rivlerësimit është regjistruar si klient i kësaj banke me disa llogari, nga të cilat vetëm llogaria *Depozitë Dinamike 4x4* është llogari me status aktiv.

28.1.2 Nga verifikimi i këtyre llogarive në “FiBank” konstatohet se gjendja e llogarive rrjedhëse dhe e depozitave në fund të çdo viti, paraqitet në tabelën si më poshtë:

GJENDJA/ FUND VITI	LLOGARITË RRJEDHËSE		DEPOZITAT/LEKË		
	LEKË	EURO	DEPOZITA 1	DEPOZITA 2	DEPOZITA 3
2010	34		1,821,438		
2011	635		1,168,306	1,196,849	
2012	805				2,469,700
2013	296				1,965,900
2014	704	32			988,400
2015	-356	20			1,083,300
2016	30,760	0			1,083,300
2017					515,528

28.1.3 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI konstatohet se subjekti ka deklaruar saktë shtesat dhe pakësimet e llogarive depozitë, si edhe gjendjet e tyre në fund të vitit.

28.1.4 Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “First Investment Bank”, konfirmohet se gjendja e këtyre dy llogarive përputhet¹¹ me deklarin e bërë nga ana e subjektit (për momentin kur ato janë deklaruar).

28.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “First Investment Bank”. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këto pasuri.

29. Depozitë në “Bankën Ndërkombëtare Tregtare” (ICB)¹², e çelur në datën 29.8.2016, me afat 3 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 1,055,325 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 %;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita bankare e mëparshme në vlerën prej 1,000,000 lekësh + interesin e përfituar nga maturimi i depozitës, të lëna sërish në depozitë, të krijuara në vite nga depozitat e mëparshme + interesi bankar; me burim fillestar

⁹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratën (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) *statement* nga “FiBank” i datës 20.1.2017; dhe (2) kontratë për hapje llogarie rrjedhëse e datës 27.8.2010.

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2018.

¹¹ Llogarisë rrjedhëse dhe llogarisë depozitë në “FiBank”, të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

¹² Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratën (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): Kontratë depozite me “ICB”, e datës 29.8.2016 për hapje depozite nga z. Roland Jaupaj në vlerën 1,055,325 lekë, me afat 3 vjet.

të ardhurat nga puna si gjyqtar dhe ato si pedagog në Universitetin “****” në periudhën 2010 – 2013.

29.1 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

29.1.1 “Banka Ndërkombëtare Tregtare”¹³ na informon se subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë llogari me interes nga viti 2011 e në vazhdim dhe se një nga depozitat aktive që disponon në këtë bankë është depozita me vlerë 1,055,325 lekë, me afat maturimi 36 muaj (29.8.2016 – 29.8.2019).

29.1.2 Nga verifikimi i kësaj llogarie depozitë në “Bankën Ndërkombëtare Tregtare” rezultoi se gjendja e saj në fund të çdo viti, paraqitet si më poshtë:

- i. për vitin 2011, gjendja 400,000 lekë;
- ii. për vitin 2012, gjendja 0 lekë;
- iii. për vitin 2013, gjendja 0 lekë;
- iv. për vitin 2014, gjendja 1,000,000 lekë;
- v. për vitin 2015, gjendja 1,000,000 lekë;
- vi. për vitin 2016, gjendja 1,055,325 lekë.

29.1.3 Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI konstatohet se subjekti ka deklaruar saktë shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie depozitë, si edhe gjendjet e saj në fund të vitit.

29.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Banka Ndërkombëtare Tregtare”. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

30. Depozitë në “Bankën Ndërkombëtare Tregtare” me vlerë 1,300,000 lekë

30.1 Gjithashtu, Banka Ndërkombëtare Tregtare na ka informuar se subjekti i rivlerësimit në datën 31.8.2017¹⁴ ka çelur depozitën me vlerë 1,300,000 lekë, me afat maturimi 60 muaj.

30.2 Komisioni kreu verifikime lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite. Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2017¹⁵, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konstatohet se subjekti ka deklaruar depozitën me afat 5 vjet, të hapur në “Bankën Ndërkombëtare Tregtare” në datën 31.8.2017.

30.3 Si burim të krijimit të kësaj depozite ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga tërheqja e shumës prej 991,883 lekësh nga “Veneto Bank”, si edhe të një pjese të shumës prej 600,000 lekësh të tërhequra nga depozita në “First Investment Bank”.

30.4 Sikurse e kemi evidentuar edhe më lart, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit në datën 31.8.2017 ka tërhequr *cash* shumën prej 991,883 lekësh nga depozita me nr. *** në “Veneto Bank”, e çelur në datën 25.8.2014, me afat 3-vjeçar, deklaruar me gjendje 900,000 lekë në deklaratën “Vetting” nga subjekti.

30.5 Po ashtu, nga verifikimi i llogarisë depozitë në “First Investment Bank” konstatohet se në datën 31.8.2017, subjekti ka tërhequr *cash* shumën prej 600,000 lekësh, e cila ishte

¹³ Me shkresat nr. *** prot., datë 25.4.2018 dhe nr. ***, datë 22.1.2019.

¹⁴ Pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

¹⁵ Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2019.

pjesë e depozitës së çelur në datën 31.8.2015, me afat 2-vjeçar, deklaruar me gjendje 1,083,000 në deklaratën “Vetting” nga subjekti.

30.6 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit i bërë në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2017 përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Banka Ndërkombëtare Tregtare”. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këto pasuri.

31. Gjendje e kursimeve në “Intesa Sanpaolo Bank”¹⁶:

- i. vlera e deklaruar: 504,754 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 %;
- iii. burimi i krijimit: të ardhurat nga paga si gjyqtar.

Subjekti ka deklaruar se kjo është llogari page ku disbursohet paga e tij si gjyqtar dhe se vlera prej 504,754 lekësh është si rezultat i mostërheqjes së shumave të rrjedhura nga paga.

31.1 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri:

31.1.1 “Intesa Sanpaolo Bank”¹⁷ na informon se subjekti i rivlerësimit ka llogari me nr. *** (*Base Number*).

31.1.2 Nga verifikimi i kësaj llogarie konfirmohet se kjo është llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit dhe se gjendja e saj në momentin e deklarimit (datë 26.1.2017) është në vlerën 504,754 lekë.

31.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

32. Automjet tip “Mercedes Benz”¹⁸, me targa AA * IM, viti i prodhimit 2003, i blerë nga subjekti në vitin 2014:**

- i. vlera e deklaruar: 400,000 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 %;
- iii. burimi i krijimit: të ardhurat e deklaruara si kursime *cash* në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2013; të ardhurat nga paga për vitin 2014.

32.1 Mënyra e fitimit të pasurisë: Kontratë shitblerjeje me nr. ***, datë 15.6.2014, e redaktuar nga noteri publik G.D.

32.2 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

32.2.1 Referuar Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2014, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, me vlerë 400,000 lekë, me targa AA *** IM, sipas kontratës nr. ***, datë 15.6.2014, redaktuar nga noteri G.D., Fier. Si burim krijimi për blerjen e këtij automjeti ka deklaruar lekët *cash* të kursyera për vitin 2013 dhe të ardhurat nga paga për vitin 2014.

¹⁶ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): Nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 20.1.2017, ku gjendja e llogarisë së pagës së z. Roland Jaupaj në datën 9.1.2017 është 504,754 lekë.

¹⁷ Me shkresat nr. *** prot., datë 25.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 22.2.2019.

¹⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): Kontratë shitblerjeje automjeti me nr. ***, datë 15.6.2014.

32.2.2 Nga verifikimi i Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2013 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesë gjendje *cash* shumë prej 235,000 lekësh. Në deklarimin për vitin 2012 subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* në vlerën prej 450,000 lekësh. Si rrjedhim, sipas vetëdeklarimit gjendja *cash* në fund të vitit 2013 është në vlerën 685,000 lekë.

32.2.3 Gjithashtu, referuar Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2014, subjekti ka deklaruar shtesë gjendje *cash* në shumë prej 65,000 lekësh. Subjekti ka shpjeguar se gjendja totale *cash* në fund të vitit 2014 është në vlerën 750,000 lekë, nga të cilat 685,000 lekë gjendja *cash* në fund të vitit 2013¹⁹ dhe 65,000 lekë shtesa për vitin 2014.

32.2.4 Pra, rezulton se subjekti në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2014 nga njëra anë ka deklaruar si burim krijimi të blerjes së autoveturës kursimet *cash* të vitit 2013, nga ana tjetër, në po të njëjtën deklaratë nuk deklaroi pakësim gjendjeje *cash*, por deklaroi gjendjen e plotë të mbartur nga deklarimi i mëparshëm dhe shtesën e vitit përkatës, në këtë rast, të vitit 2014.

32.2.5 Nga ana e Komisionit u verifikua llogaria e pagës së subjektit në “BKT”, nga ku rezultoi se subjekti ka tërhequr *cash* nga kjo llogari në total shumë prej 280,000 lekësh, për periudhën nga janar 2014 deri në datën 15.6.2014²⁰.

32.2.6 DPSHTRR-ja²¹, na informon se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi mjetin me targë AA *** IM. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti²² konstatohet se në datën 25.3.2014 ky mjet është blerë në Itali nga shoqëria “***” sh.p.k., për vlerën 3,000 euro.

32.2.7 Pasi kreu procedurat e zhdoganimit, shoqëria “***” sh.p.k., në datën 31.4.2014, me kontratë shitjeje dhe faturë tatimore me nr. serie *** , ia shet këtë mjet shtetasit E. T., për vlerën 540,000 lekë.

32.2.8 Në datën 15.6.2014, shtetasi E.T., ia shet këtë automjet subjektit të rivlerësimit për vlerën 400,000 lekë. Referuar kontratës së shitblerjes së këtij mjeti, blerësi (subjekti i rivlerësimit) ka deklaruar se ka likuiduar shumë prej 400,000 lekësh dhe se e ka marrë në dorëzim mjetin në gjendje të rregullt teknike.

32.3 Për sa më sipër, duket se subjekti ka përfutur trajtim preferencial me blerjen e këtij automjeti.

32.4 Komisioni i kërkoi²³ noterit G.D. t'i vërë në dispozicion Komisionit kontratën e shitblerjes së këtij automjeti dhe dokumentacionin shoqëruar të saj, të lidhur mes shtetasve E.T., dhe Roland Jaupaj.

32.4.1 Noteri publik, z. G.D.²⁴, dërgoi në Komision kopje të kësaj kontrate, nga ku vërejmë se ajo është e njëjtë në formë dhe në përmbajtje me kontratën e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe që gjendet në dosjen e DPSHTRR-së.

¹⁹ Sipas vetëdeklarimit në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2013.

²⁰ Dita kur është kryer blerja e automjetit.

²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2019.

²² Përcjellë nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2019.

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2019.

²⁴ Me shkresën e datës 18.2.2019, protokolluar me tonën me nr. *** prot., datë 19.10.2018.

32.5 Gjithashtu, nisur nga të dhënat e mësipërme, Komisioni konstatoi se: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së; dhe subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të këtij aseti.

32.6 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e Komisionit se ka përfituar trajtim preferencial me blerjen e këtij automjeti, dhe se ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të këtij aseti.

32.6.1 Në prapësimet²⁵ e sjella në Komision, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se për blerjen e këtij automjeti janë përdorur vlera nga kursimet *cash* të vitit 2013 dhe të ardhura nga pagat për vitin 2014. Pasi bën një shpjegim të gjatë të mënyrës së tij se si e ka konceptuar deklarimin në ILDKPKI, në thelb, subjekti sqaron se për blerjen e këtij automjeti janë përdorur të ardhurat të deklaruara si gjendje *cash* në vitin 2013, për të cilat thotë se janë kompensuar me të ardhura të tjera të krijuara përgjatë vitit 2014 dhe se kjo shpjegon faktin se pse shtesa e gjendjes *cash* për vitin 2014 është në vlerën 65,000 lekë.

32.6.2 Lidhur me konstatimin se ka përfituar trajtim preferencial në blerjen e këtij automjeti në prapësimet²⁶ e sjella në Komision, subjekti ka shpjeguar se në blerjen e këtij automjeti ka vlerësuar gjendjen teknike në momentin e blerjes, karakteristikat, nevojat e afërta për shërbime, çmimin e tregut në kohën e blerjes, si dhe disa rrethana të tjera të veçanta. Kështu, në mënyrë të përmbledhur, lidhur me çmimin e paguar për këtë automjet, subjekti deklaroi se nuk ka përfituar trajtim preferencial, pasi:

- i. ky mjet është blerë nga djali i kushërirës së parë të mamasë së subjektit;
- ii. shitësi kishte nevoja financiare urgjente;
- iii. mjeti kishte nevojë për disa shërbime.

32.6.3 Për të provuar deklarimet e tij, subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur në Komision dokumentet si më poshtë:

- i. deklaratë noteriale e shtetasit E.T.²⁷;
- ii. tri kontrata shitjeje²⁸ mjeti me shitës shtetasin E.T.

32.6.4 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues.

32.6.5 Si përfundim, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, deklarimeve të dhëna dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, faktit se nga analiza financiare e kryer për vitin 2014 paraqitet balancë pozitive e fondeve, Komisioni çmon se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti dhe se nuk ndodhet në kushtet e trajtimit preferencial.

33. Gjendje *cash*, shumën prej 1,200,000 lekësh

²⁵ Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

²⁶ Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

²⁷ Kontratë noteriale nr. ***, datë 10.5.2019.

²⁸ (1) Kontrata noteriale nr. ***, datë 4.8.2014; (2) Kontrata noteriale nr. *** kol., datë 4.8.2014 dhe; (3) Kontrata noteriale nr. ***, datë 4.8.2014.

33.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI konstatohet se subjekti, në vazhdimësi, ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjeve të likuiditeteve *cash*, të cilat, të paktën sipas vetëdeklarimit, justifikojnë krijimin e kësaj gjendjeje në *cash*, deklaruar në deklaratën “Vetting”.

34. Analizë për treguesit financiarë të subjektit për periudhën 2005 – 2009

34.1 Për këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banuar me familjen në banesën me adresë: Lagjja “****”, Rr. “****”, p. ***, shk. ***, Fier.

34.2 Të ardhurat e vërtetuara për këtë periudhë nga puna dhe Shkolla e Magjistraturës kanë qenë në vlerë 3,889,433 lekë, të ndara në vite si më poshtë:

- i. për vitin 2005, shumën prej 540,783 lekësh;
- ii. për vitin 2006, shumën prej 781,897 lekësh;
- iii. për vitin 2007, shumën prej 806,554 lekësh;
- iv. për vitin 2008, shumën prej 873,236 lekësh;
- v. për vitin 2009, shumën prej 886,963 lekësh.

34.3 Në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2006 subjekti i rivlerësimit deklaroi depozitë me afat, e çelur në datën 25.9.2006; vlera 3,011 euro; pjesa takuese: 100 %.

34.3.1 Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, subjekti i rivlerësimit në datën 24.3.2006 ka depozituar *cash* në llogarinë nr. *** në valutën *euro*, shumën 1,500 euro dhe në datën 25.9.2006 ka kaluar në depozitë “*Fleks*” shumën 1,512.59 euro. Po në datën 25.9.2006 subjekti ka depozituar shumën 1,500 euro dhe nga bashkimi i këtyre shumave ka kaluar në depozitë me afat 1-vjecar shumën 3,011 euro.

34.3.2 Nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2005, si edhe vetëdeklarimeve të subjektit në pyetësin nr. 2²⁹ për shpenzimet jetike dhe të transportit për vitin 2006, Komisioni kreu analizë financiare për periudhën 1.1.2006 – 25.9.2006, të dhënat e së cilës reflektohen në tabelën e mëposhtme:

Analizë financiare për periudhën 1.1.2006 – 25.9.2006

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga paga e subjektit, periudha 1.1.2006 – 25.9.2006	593,073
Total të ardhura	593,073
Pagesat për shpenzime jetese dhe transport (9 muaj) deklaruar në pyetësin nr. 2	157,500
Total shpenzime	157,500
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> në banesë gj. 1.1.2006 – 25.9.2006	0
Ndryshim mjete monetare banke gj. 1.1.2006 – 25.9.2006	-548,783
Mjete monetare të disponueshme (1)	-113,210
Pagesa për blerje pasurie te paluajtshme dhe të luajtshme	0
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	-113,210

²⁹ Pyetësin nr. 2/ përgjigjet e sjella nga subjekti, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.3.2019.

34.3.3 *Nga sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e depozitës në shumë 3,011 euro në datën 25.9.2006, në “Intesa Sanpaolo Bank”.*

34.4 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me burimet e financiare që kanë shërbyer për krijimin e depozitës në shumën prej 3,011 eurosh në datën 25.9.2006.

34.5 Në prapësimet³⁰ e sjella pranë Komisionit, subjekti ka shpjeguar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, si pasojë e mosinstruktimit për mënyrën e plotësimit të të dhënave në deklaratën e pasurisë, ka deklaruar vetëm të ardhurat dhe nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në fund të vitit 2005. Subjekti, gjithashtu, deklaroi se në fund të vitit 2005 ka kursyer shumën prej 250,000 lekësh dhe se, megjithëse nuk e ka pasqyruar në deklaratën periodike vjetore, nuk ka pasur asnjë qëllim fshehjen e kësaj pasurie, por duke marrë parasysh që ka qenë deklarata e parë e plotësuar prej tij, ka menduar se për veprimet monetare të kryera vlerësohet sasia e të ardhurave të ligjshme dhe e shpenzimeve të dokumentuara sipas ligjit dhe, diferenca e pashpenzuar që mbetet është kursim *cash*.

34.5.1 Ky pretendim nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni pasi ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në prova.

34.6 Referuar të dhënave të “Intesa Sanpaolo Bank” rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në datën 31.12.2006, ka gjendjen në vlerën prej 102,527 lekësh.

34.6.1 *Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e kësaj llogarie në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2006.*

34.7 Në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: (1) pakësimin e depozitës me afat në “Raiffeisen Bank” (mbyllur në datën 29.3.2007); (2) shtim depozite në “Raiffeisen Bank” në vlerë 100,000 lekë; dhe (3) shtim depozitë në “Bankën Amerikane” në vlerën 400,000 lekë.

34.7.1 Referuar të dhënave nga “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Amerikane) rezultoi se në datën 27.11.2007, subjekti i rivlerësimit ka kaluar në depozitë pa afat shumën prej 400,000 lekësh dhe se kjo shumë është krijuar si rezultat i mostërheqjes së pagës nga subjekti. Ndërsa, gjendja e llogarisë së pagës në datën 31.12.2007 është në vlerën 167,593 lekë.

34.7.2 *Nga sa më sipër konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”, në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2007.*

34.8 Në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* në vlerën prej 530,000 lekësh, të krijuar nga kursimet e të ardhurave nga paga si gjyqtar, nga depozitat dhe interesat e përfituara prej tyre.

34.8.1 Referuar të dhënave të dërguara nga “Intesa Sanpaolo Bank” rezultoi se në datën 28.8.2008 subjekti i rivlerësimit ka kaluar në depozitë me afat shumën prej 500,000 lekësh. Në datën 2.12.2008 janë kthyer dy depozitat, përkatësisht njëra në vlerën prej

³⁰ Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

513,019 lekësh dhe tjetra në vlerën prej 423,055 lekësh. Po në datën 2.12.2008 kanë kaluar në depozitë shumat prej 320,000 lekësh dhe 330,000 lekësh, ndërsa shuma prej 605,700 lekësh është tërhequr *cash*.

34.8.2 Ndërkohë, nga verifikimi i llogarisë rrjedhëse të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se gjendja e saj në datën 31.12.2008 është në vlerën 210,945 lekë.

34.8.3 *Konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank” në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2008.*

34.8.4 Analiza financiare e vitit 2008 lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur pasqyrohet si më poshtë:

Analizë financiare periudha 1.1.2008 – 31.12.2008

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, viti 2008	873,236
Të ardhura të tjera ³¹	13,019
Total të ardhura	886,255
Shpenzime të tjera ³²	75,700
Pagesat për shpenzime jetese	136,620
Total shpenzime	212,320
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> në banesë gj. 1.1.2008 – 31.12.2008	-530,000
Ndryshim mjete monetare banke gj. 1.1.2008 – 31.12.2008	-257,867
Mjete monetare të disponueshme (1)	-113,932
Pagesa për blerje pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme	0
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	- 113,932

34.8.5 Nga sa më sipër, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të deklaruara (*cash* + bankë) dhe shpenzimet e kryera.

34.9 Nga analiza financiare e kryer, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2005 – 2009, rezulton balanca e fondeve si më poshtë:

- i. për vitin 2005 (datë 31.12.2005), vlera 275,057 lekë;
- ii. për vitin 2006 (datë 31.12.2006), vlera 21,855 lekë;
- iii. për vitin 2007 (datë 31.12.2007), vlera 243,001 lekë;
- iv. për vitin 2008 (datë 31.12.2008), vlera -113,932 lekë;
- v. për vitin 2009 (datë 31.12.2009), vlera 46,636 lekë.

34.10 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me burimet e financiare që kanë shërbyer krijimin e likuiditeteve të deklaruara (*cash* + bankë) dhe shpenzimet e kryera për vitin

³¹ Të ardhura nga interesat.

³² Shpenzime deklaruar në pyetësor.

2008. Gjithashtu, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me mosdeklarimin e gjendjeve të llogarive bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” për vitet 2006, 2007 dhe 2008.

34.11 Në prapësimet³³ e sjella subjekti dha shpjegimet e tij, të cilat u shqyrtuan me objektivitet nga Komisioni.

34.12 Lidhur me mosdeklarimet e gjendjeve të llogarive bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” për vitet 2006, 2007 dhe 2008, subjekti shpjegon se ka ardhur si pasojë e mosinstruktimit për mënyrën e plotësimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe se nuk ka pasur asnjë qëllim fshehjen, për sa kohë të dhënat janë në bankë. Në vijim subjekti sqaron se ka qenë padijenia e tij për mënyrën e saktë të plotësimit të deklaratës së pasurisë, e cila verifikohet fare lehtë pasi është e tillë vetëm për deklaratat e para të pasurisë.

34.12.1 Nga verifikimi i dokumentit nxjerrje llogarie të dërguar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, konstatohet se kemi të bëjmë me llogari ku disbursohet paga e subjektit të rivlerësimit.

34.12.2 Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me gjendje llogarie page të krijuar nga mostërheqja e një pjese së saj, Komisioni vlerëson se nuk ka dyshime se subjekti të ketë pasur si qëllim mosdeklarimin apo fshehjen e tyre. Gjithashtu, Komisioni çmon se këto pasaktësi në deklarimet periodike ndër vite në ILDKPKI nuk sjellin pasoja në këtë proces, pasi nuk cenojnë ligjshmërinë e burimit të këtyre llogarive bankare, për kohën kur ato janë krijuar.

34.13 Lidhur me pamundësinë financiare të subjektit për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të deklaruara (*cash* + bankë) dhe shpenzimet e kryera për vitin 2008, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, nga të cilat Komisioni, pasi i analizoi me objektivitet, mori në konsideratë: (1) të ardhura të tjera shtesë nga interesat; dhe (2) rivlerësoi shpenzimet e muajit dhjetor të subjektit, të cilat ndryshojnë vlerën totale të shpenzimeve jetike të subjektit.

34.13.1 Pas reflektimit nga Komisioni të të dhënave të reja që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit, analiza financiare për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2008, paraqitet si më poshtë:

Analizë për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2008 pas shpjegimeve

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga paga subjekti, viti 2008, vërtetim	873,236
Të ardhura të tjera	36,073
Total të ardhura	909,309
Shpenzime të tjera deklaruar	75,700
Pagesat për shpenzime jetese referuar INSTAT, ILDKPKI	125,235
Total shpenzime	200,935
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> në banesë gj. 1.1.2008 – 31.12.2008	-530,000
Ndryshim mjete monetare banke gj. 1.1.2008 – 31.12.2008	-257,867
Mjete monetare të disponueshme (1)	-79,493
Pagesa për blerje pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme	0

³³ Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	-79,493

34.14 Si përfundim, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të deklaruara (*cash* + bankë) dhe shpenzimet e kryera për vitin 2008.

35. Analizë për treguesit financiarë të familjes së subjektit, periudha 2010 – 2016

35.1. Referuar Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2010 dhe dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në këtë vit subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me znj. R.M. (Jaupaj). Bazuar në dokumentin, certifikatë martese, të administruar në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe znj. R.M., (Jaupaj) kanë lidhur martesë në datën 16.9.2010. Në analizën financiare të vitit 2010 e në vijim, do të analizohen shtesat e pasurive të realizuara nga subjekti i rivlerësimit së bashku me personin e lidhur. Pasuritë e evidentuara si të krijuara nga personi i lidhur deri në fund të vitit 2009, do të analizohen më vete.

35.2 Nga analiza financiare e kryer, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe deklaratimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2010 – 2016, Komisioni paraprakisht konstatoi se rezulton balanca e fondeve si më poshtë:

- i. për vitin 2010 (datë 31.12.2010), vlera -154,575 lekë;
- ii. për vitin 2011 (datë 31.12.2011), vlera 198,173 lekë;
- iii. për vitin 2012 (datë 31.12.2012), vlera 171,923 lekë;
- iv. për vitin 2013 (datë 31.12.2013), vlera 950 lekë;
- v. për vitin 2014 (datë 31.12.2014), vlera 223,498 lekë;
- vi. për vitin 2015 (datë 31.12.2015), vlera 225,519 lekë;
- vii. për vitin 2016 (datë 31.12.2016), vlera 386,925 lekë.

35.3. Analiza financiare e vitit 2010 lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, pasqyrohet si më poshtë:

Analiza financiare për periudhën 01.01.2010-31.12.2010

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga paga e subjektit, viti 2010	869,062
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, viti 2010	328,968
Të ardhura Universiteti “***”	156,616
Shpërblim fëmija	8,410
Të ardhura të tjera	429,079
Total të ardhura	1,792,135
Pagesat për shpenzime jetese referuar INSTAT, ILDKPKI	296,010
Total shpenzime	296,010
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> në banesë gj. 1.1.2010 – 31.12.2010	-85,840
Ndryshim mjete monetare banke gj. 1.1.2010 – 31.12.2010	-1,564,860
Mjete monetare të disponueshme (1)	-154,575
Pagesa për blerje pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme	0

Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	-154,575

35.4 Për sa më sipër, dukej se subjekti kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara (likuiditete *cash* dhe në bankë) dhe shpenzimet e kryera për vitin 2010.

35.5 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare të subjektit për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të deklaruara (*cash* + bankë) dhe shpenzimet e kryera për vitin 2010, subjekti paraqiti shpjegimet e tij³⁴, nga të cilat Komisioni, pasi i analizoi me objektivitet, mori në konsideratë: (1) të ardhura të tjera shtesë nga pagat e subjektit dhe e bashkëshortes; dhe (2) të ardhura të tjera të përfituara nga interesat bankare.

35.5.1 Pas reflektimit nga Komisioni të të dhënave të reja që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit, analiza financiare për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010, paraqitet si më poshtë:

Analizë për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010 pas shpjegimeve

Përshkrimi	Vlera në Lek
Të ardhurat nga paga e subjektit, viti 2010	871,654
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, viti 2010	375,562
Të ardhura Universiteti “****”	156,616
Shpërblim fëmija	8,410
Të ardhura të tjera	633,615
Total të ardhura	2,045,857
Pagesat për shpenzime jetese referuar INSTAT, ILDKPKI	296,010
Total shpenzime	296,010
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> në banesë gj. 1.1.2010 – 31.12.2010	-85,840
Ndryshim mjete monetare banke gj. 1.1.2010 – 31.12.2010	- 1,564,860
Mjete monetare të disponueshme (1)	99,147
Pagesa për blerje pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme	0
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	99,147

35.6 Si përfundim, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të deklaruara (*cash* + bankë) dhe shpenzimet e kryera për vitin 2010.

36. Pasuritë në përdorim nga ana e subjektit të rivlerësimit

36.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si adresë banimi: Lagjja “****”, Rr. “****”, Fier, por nuk rezulton të ketë deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi, me qira apo në përdorim, në këtë adresë.

³⁴ Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

36.2 I pyetur nga Komisioni nëse në shtatë vitet e fundit ka përdorur pasuri të regjistruara në emër të dikujt tjetër, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *ai, së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët e tij në periudhën 2011 – 2017, kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë në një dhomë në apartamentin në bashkëpronësi të prindërve të tij, i ndodhur në lagjen “***”, Rr. “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Fier, adresë të cilën thotë se e ka deklaruar si adresë banimi në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2011 – 2017. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se për të parkuar makinën e tij, ka përdorur garazhin në bashkëpronësi të prindërve të tij, të ndodhur në të njëjtin objekt me apartamentin.*

36.3 Komisioni vlerëson se, në përputhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, pikat 11, 19 të nenit 3, dhe nenin 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe nenin 4, të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën “Vetting” këto pasuri në përdorim nga ana e tij, si dhe të paraqiste dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të tyre.

36.4 Referuar pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, *pasuri konsiderohen të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj*, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, subjekti ka detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, si dhe burimin e krijimit të këtyre pasurive.

36.5 Sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Ndërsa, në pikën 3 të këtij neni parashikohet se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave.

36.6 Në pikën 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

36.7 Për sa më sipër, konstatohet se subjekti nuk i ka deklaruar këto pasuri në përdorim nga ana e tij në deklaratën “Vetting” dhe, si rrjedhojë, nuk ka dorëzuar dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e tyre.

36.8 ZVRPP-ja Fier³⁵, na informon se në emër të z. M.S.J., dhe znj. A.L.L.J., (si bashkëpronarë) figurojnë të regjistruara pasuritë si më poshtë:

- i. pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 170 m², e papajisur me certifikatë pronësie;

³⁵ Me shkresat nr. *** prot., datë 24.04.2018; nr *** prot., datë 2.8.2018; dhe nr. *** prot., datë 1.3.2019.

- ii. pasuria nr. ***, vol. 23, f. 128, e llojit apartament me sip. 22 m², e papajisur me certifikatë pronësie.

36.9 Pasuritë objekt hetimi, apartament banimi me sip. 170 m² dhe garazh me sip. 22 m²

36.9.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 21.6.2012, nëpërmjet kontratës së shitblerjes së pasurisë së patundshme³⁶, z. M. J., (babai i subjektit të rivlerësimit), ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor, z. B.Z., apartament banimi me sipërfaqe ndërtimore 170 m² për vlerën prej 3,600,000 lekësh dhe bodrum me sipërfaqe ndërtimore 22 m² për vlerën prej 400,000 lekësh, në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në lagjen “****”, Rr. “****”, Fier. Këto pasuri janë regjistruar në ZVRPP-në Fier në emër të M., dhe A.J. (prindërit e subjektit).

36.9.2 Referuar kësaj kontrate, në nenin 2 të saj thuhet shprehimisht: “...sot, në datën e nënshkrimit të kontratës nga ana e blerësit, është likuiduar plotësisht çmimi i shitjes për llogari të palës shitëse, pagesë e cila sipas deklaramentit të palëve është bërë cash në dorë, jashtë zyrës së noterisë, para redaktimit të kësaj kontrate”.

36.9.3 Në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI dhe në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi që prej vitit 2010, pikërisht adresën e apartamentit të ndodhur në objektin e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., por nuk ka deklaruar lidhjen që ka me të dhe as që e ka në përdorim.

36.9.4 I pyetur nga Komisioni se kur ka filluar të banojë në apartamentin e ndodhur në godinën e shoqërisë “****” sh.p.k., në lagjen “****”, Fier, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “...me sa mbaj mend, banesa ka filluar të përdoret në periudhën fund prilli – maji të vitit 2010, ku vetëm pak familje ishin futur për banim dhe në pallat vazhdonin punimet.”

36.9.5 Komisioni disponon të dhëna që marrëdhënia mes shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe babait të subjektit të rivlerësimit, z. M.J., ka nisur që në fillim të vitit 2010, sipas vetëdeklarimeve të bëra, por dhe nga librezat dhe kontratat me OSHEE-në³⁷ dhe UKT-në³⁸, administruar si prova në dosje. Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë filluar të banojnë në këtë apartament që prej vitit 2010.

36.9.6 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Fier rezulton se, në datën 5.7.2012, është bërë rivlerësimi i këtyre pasurive (rreth 15 ditë pas blerjes së tyre), nga ku çmimi i apartamentit është rivlerësuar në vlerën prej 9,945,000 lekësh dhe çmimi i bodrumit është rivlerësuar në vlerën prej 900,900 lekësh.

36.9.7 Ndërsa, referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, e konkretisht tabelës nr. 2, ku parashikohet lista e qyteteve për çmimet e tregut të lirë, rezulton se çmimi mesatar i shitjes lekë/m² sipërfaqe e shfrytëzueshme për qytetin e Fierit, për vitin 2010 është në vlerën 56,094 lekë.

³⁶ Me nr. ***.

³⁷ Libreza e pagesave të energjisë elektrike dhe kontrata e dorëzuar nga subjekti.

³⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 27.2.2019, UK-në Fier; (2) libreza e ujit dhe kontrata me UK-në Fier e dorëzuar nga subjekti.

36.9.8. I pyetur nga Komisioni, se pse babai i tij i ka blerë këto pasuri me çmim shumë më të ulët në krahasim me çmimet e tregut në qytetin e Fierit për atë periudhë (të aplikuara dhe nga ZVRPP-ja Fier), subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se: *...babai i tij i ka blerë këto pasuri me këtë çmim, pasi 50 m² nga sipërfaqja e apartamentit janë verandë e hapur dhe çmimi është sa 1/4 e çmimit të sipërfaqes së brendshme të apartamentit, si edhe një pjesë të punimeve dhe të materialeve i ka siguruar vetë babai, duke i bërë zbritje nga pagesa e shitjes së banesës.* Këto punime dhe materialet, sipas vetëdeklarimit dhe disa deklaratave të dërguara, llogariten përafërsisht në vlerën prej 1,7 milionë lekë.

36.9.9. Komisioni i kërkoi shoqërisë “****”³⁹ sh.p.k. të konfirmojë: (1) nëse mes shoqërisë dhe shtetasit M.J., ka pasur kontratë sipërmarrje/prenotimi, lidhur me këto dy pasuri; (2) kohën kur i janë dorëzuar këto dy pasuri shtetasit M.J., dhe a është mbajtur procesverbal dorëzimi; (3) mënyrën e kryerjes së pagesës (cash apo përmes bankës) për blerjen e këtyre dy pasurive, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës; si dhe (4) çdo të dhënë dhe dokumentacion tjetër që kjo shoqëri disponon lidhur me marrëdhënien me shtetasin M. J.

36.9.10 Shoqëria “****”⁴⁰ sh.p.k., na informon se nga kërkimi i bërë në arkivin e saj për veprimet e kryera me z. M.J., rezulton dokumenti kontratë shitjeje me nr. ***, datë 21.06.2012. Kjo shoqëri na konfirmon se nuk ka pasur kontratë sipërmarrje/prenotimi për këto pasuri, me këtë shtetas. Lidhur me periudhën se kur i janë dorëzuar pasuritë kjo shoqëri na informon se, nuk disponon dokument për kohën se kur i janë vënë në dispozicion pasuritë shtetasit M.J., por në konsultim me punonjësit e saj, shpjegon se këto pasuri i janë dorëzuar brenda 6 mujorit të parë të vitit 2010, në një kohë që punimet tërësore nuk kishin përfunduar akoma. Gjithashtu shoqëria “****” sh.p.k. na informon se një pjesë e materialeve dhe punimeve të brendshme i ka përballuar vetë shtetasi M. S.J., të cilat nuk janë mbajtur parasysh në llogaritjen e çmimit të shitjes së apartamentit.

36.9.11 Komisioni ka konstatuar se, **z. Roland Jaupaj**, ka gjykuar çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: paditës z. A.K., palë e paditur Këshilli i Rregullimit të Territorit Bashkia Fier, ndërhyrës dytësor, z. A.K., *persona të tretë shoqëria “****” sh.p.k.*, me përfaqësuese znj. A.A., me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 28.3.2008, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Fier, “Për miratimin e Sheshit të Ndërtimit” dhe të vendimit nr. ***, datë 10.6.2008, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Fier, “Për dhënien e Lejes së Ndërtimit”. Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 21.4.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

36.9.12 *Duket se, apartamenti dhe bodrumi i blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit ndodhen pikërisht në godinën e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor.*

36.10 Komisioni i kërkoi⁴¹ ILDKPKI-së të japë vlerësim nëse nga situata e mësipërme subjekti i rivlerësimit gjendet ose jo në ndonjë nga format e konfliktit të interesit, parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2019.

⁴⁰ Me shkresën e datës 4.3.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.3.2019.

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.3.2019.

36.10.1 ILDKPKI-ja⁴², nga analizimi ligjor i rastit, ka arritur në konkluzionin se nuk mund të vlerësohet dot nëse zyrtari/gjyqtar, z. Roland Jaupaj, ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në gjykimin e çështjes me palë shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe në vendimmarrjen gjyqësore, pra, nëse gjendemi para një “*konflikti faktik interesi*”, si dhe një nga llojet e “*konfliktit rast për rast të interesit*”. Sipas ILDKPKI-së, nuk rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, në lidhje me vendimmarrjen e kësaj çështjeje gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

36.11 Gjithsesi, në analizë të të dhënave të mësipërme, Komisioni vlerëson se babai i subjektit ka pasur trajtim preferencial në marrëdhënien me shoqërinë “****” sh.p.k., kjo pasi:

- i. ka përdorur pasurinë e kësaj shoqërie për rreth dy vjet pa pasur ndonjë dokument shkresor apo kontratë të lidhur me shoqërinë, si edhe pa kryer ndonjë pagesë për shoqërinë;
- ii. ka pasur garanci të plota për përfitimin e kësaj pasurie 2 vjet përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, pasi sipas vetëdeklarimit, gjatë kësaj periudhe ka kryer investime në vlera të konsiderueshme në këtë apartament;
- iii. çmimi i shitjes së apartamentit dhe bodrumit/garazhit është dukshëm më i ulët se vlera e tregut.

36.12 Për sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti ka përfituar trajtim preferencial lidhur me këto pasuri, në kundërshtim me nenet 23⁴³ dhe 24⁴⁴, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

36.12.1 Pas kalimit të barrës së provës subjekti dërgoi prapësimet⁴⁵ e tij, të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se nuk arriti të provojë të kundërtën e këtij konstatimi.

37. Analiza financiare e personave të tjerë të lidhur

37.1 Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përdorur dhe vazhdon të përdorë dy pasuritë e mësipërme, Komisioni vlerëson se, referuar pikës 14, të nenit 3 si edhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. M.J., dhe znj. A.J., (prindërit e subjektit të rivlerësimit), bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

37.2 Referuar certifikatës familjare të subjekti i rivlerësimit në vitin 2012 familja Jaupaj përbëhej nga 6 persona, kryefamiljar i së cilës ishte z. M.J.

⁴² Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2018.

⁴³ Pika 1, e nenit 23, e ligjit nr. 9367/2005, parashikon: “...*është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat.*”

⁴⁴ Pika 2, e nenit 24, e ligjit nr. 9367/2005, parashikon: “...*rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të nenit 23 të këtij ligji, përveç atyre të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, zgjerohet edhe me çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.*”

⁴⁵ Prapësimet e dërguara me e-mail-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

37.3 Komisioni kreu analizë financiare lidhur me mundësinë e krijimit të pasurive deri në fund të vitit 2012 për personat e lidhur, prindërit e subjektit të rivlerësimit.

37.4 Referuar dokumentacionit të ardhur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier⁴⁶ rezulton se të ardhurat e prindërve të subjektit për periudhën 1996 – 2016 kanë qenë në total në vlerën prej 9,092,022 lekësh. Gjithashtu, rezulton se deri në datën 31.12.2010 të ardhurat nga paga dhe pensioni i prindërve të subjektit të rivlerësimit kanë qenë në vlerën prej 5,866,486 lekësh.

37.5 Me kontratë shitblerjeje të datës 28.4.2010, M., dhe A.J., (prindërit e subjektit) kanë shitur apartamentin me sipërfaqe 62 m², për vlerën 3,450,000 lekë. Referuar kësaj kontrate, shuma prej 100,000 lekësh është likuiduar në datën 23.9.2009 dhe shuma prej 3,350,000 lekësh është likuiduar në datën 28.4.2010.

37.6 ZVRPP-ja Fier, informon se në emër të z. M.S.J., figurojnë të regjistruara edhe pasuritë si më poshtë:

- i. pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 23 m², i pajisur me certifikatë pronësie, në bashkëpronësi me të tretë;
- ii. pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 23 m², i pajisur me certifikatë pronësie, në bashkëpronësi me të tretë;
- iii. pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 23 m², i pajisur me certifikatë pronësie, në bashkëpronësi me të tretë.

37.6.1 Këto pasuri, në bashkëpronësi të z. M.J., me të tretë, kanë të bëjnë me shtesë anësore në pallatin 4-katësh, të ndodhur në lagjen “****”, Fier. Sheshi i ndërtimit të këtij objekti (i shtesës anësore) është miratuar me vendimin nr. ***, datë 27.12.2001, të KRRT-së të Bashkisë Fier, ndërsa leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. ***, datë 30.7.2002, të KRRT-së të Bashkisë Fier. Duket se kjo shtesë është ndërtuar në pallatin ku prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur në pronësi apartamentin me sip. 62 m².

37.6.2 Lidhur me këto pasuri në bashkëpronësi të babait, subjektit i kërkohet të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, lidhur me: (1) pjesën takuese të babait / katin në të cilën ndodhet pjesa e tij; (2) preventivin për ndërtimin e kësaj shtese, kontributin e babait në ndërtimin e saj; dhe (3) statusin aktual të kësaj pasurie.

37.6.3 Në shpjegimet e tij⁴⁷ subjekti, ndër të tjera, deklaroi se babai ka aplikuar së bashku me banorët e tjerë të pallatit (fqinjët) pronarë të apartamenteve përkatës, në katet 1-3 të pallatit, për leje ndërtimi. Në kohën e aplikimit subjekti shpjegon se babai i tij kishte në pronësi një apartament të ndodhur në katin e katërt të pallatit, ku logjikisht dhe ligjërisht pjesa takuese e babait, në objektin shtesë pallati, do të ishte ¼ e kësaj shtese pallati, që i korrespondon katit të katërt të shtesës së pallatit, ndërsa pjesët e tjera, nga ¼ respektivisht, u përkasin pronarëve të katit 1, 2 dhe 3. Subjekti deklaroi se, përveç kërkesës së bërë për leje ndërtimi, babai i tij nuk ka dhënë asnjë kontribut në ndërtimin e objektit shtesë pallati. Në vijim sqaron se nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, është

⁴⁶ Me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 25.2.2019.

⁴⁷ Referohu shpjegimeve të dhëna nga subjekti në f. 28 - 31, të materialit me titull “Opinione, Sqarime, Prova”, të dërguar nga subjekti i rivlerësimit me e-mail-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

bërë verifikimi në terren i këtij objekti shtesë pallati, ku është vërtetuar se kati i katërt i tij (kati i tretë teknik) nuk është ndërtuar asnjëherë. Lidhur me faktin se babai i tij figuron bashkëpronar në çdo kat të kësaj shtese subjekti sqaron se ka ardhur si rezultat i situatës së mosdepozitimit në ZVRPP-në Fier të një marrëveshjeje pjesëtimi/përcaktimi të pjesës takuese, midis pronarëve të secilit prej kateve të ndërtuara të objektit shtesë pallati, pasi thotë se babai i tij nuk ka bërë ndërtim.

37.6.4 Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit dokumentet si më poshtë:

- i. atkkontrolli i datës 2.2.2007 të Drejtorisë Urbanistikës, Bashkia Fier;
- ii. atkkoauidimi i objektit shtesë pallati;
- iii. shkresë⁴⁸ e ASHK-së, Drejtoria Vendore Fier, e datës 17.5.2019;
- iv. procesverbal konstatimi i ASHK-së, datë 17.5.2019, shoqëruar me foto;
- v. deklaratë noteriale⁴⁹ e datës 20.5.2019.

36.6.5 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, deklarimeve të dhëna dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues, lidhur me faktin se babai i tij nuk disponon faktikisht (nuk ka në bashkëpronësi) pasuritë shtesë pallati të cituara më sipër dhe se ka kontribuar në ndërtimin e tyre.

37.7 Siç e kemi evidentuar edhe më sipër, në datën 21.6.2012, z. M.J., ka blerë pasuritë apartament banimi me sip. 170 m² dhe bodrum me sip. 22 m², në total për vlerën prej 4,000,000 lekësh.

37.8 I pyetur nga Komisioni se cili ka qenë burimi i të ardhurave të babait të tij me të cilat ka blerë këto pasuri, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se: *...burimi i krijimit të këtyre pasurive kanë qenë të ardhurat nga pagat e babait dhe nënës së tij, të ardhurat të babait nga pagesa kalimtare si ushtarak, si edhe të ardhurat nga aktiviteti privat i babait, për të cilin deklaroi se ka punuar si tregtar ambulant, në tregun ambulant të artikujve të ndryshëm të qytetit të Fierit, për periudhën nëntor 1993 – dhjetor 2002*". Subjekti pretendon se babai i tij ka përfituar fitim vjetor mesatar nga aktiviteti i tij si ambulant në vlerat prej 600,000 deri në 700,000 lekësh.

37.9 Për të provuar faktin se babai i tij ka qenë tregtar ambulant, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklarata noteriale të babait⁵⁰ të tij dhe të disa shtetasve të tjerë⁵¹, për të cilët pretendohet se kanë kryer aktivitet tregtar si ambulantë në të njëjtën periudhë me babanë e subjektit.

37.10 Qendra Kombëtare e Biznesit⁵² nuk konfirmon aktivitet tregtar të regjistruar në emër të z. M.J. Në vijim të veprimeve hetimore, Komisioni i kërkoi Bashkisë Fier⁵³ të

⁴⁸ Shkresa me nr. *** prot., datë 17.5.2019.

⁴⁹ Deklarata me nr. ***, datë 20.5.2019.

⁵⁰ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.2.2018, depozituar si provë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.3.2019.

⁵¹ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.12.2018 e shtetasve L.L., dhe Th.B, depozituar si provë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.3.2019.

⁵² Shkresa nr. *** prot., datë 16.5.2018

⁵³ Shkresa nr. *** prot., datë 5.3.2019.

dhëna/informacion lidhur me aktivitet tregtar të regjistruar për shtetasin M.J. Bashkia Fier⁵⁴ informon se nga verifikimet e kryera në sistemin *TAIS* (Sistemi i Administrimit të Informacionit të Taksave dhe Tarifave Vendore) në të cilin regjistrohen subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi në Bashkinë Fier, nuk figurojnë të dhëna për shtetasin M.S.J.

37.10.1 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ndodhet në kushtet e pamundësisë⁵⁵ për të provuar të ardhurat e realizuara nga babai i tij nga aktiviteti si ambulant për periudhën 1993 – dhjetor 2002 dhe depozitoi si provë shkresën⁵⁶ e Drejtorisë së Taksave e Tarifave, Bashkia Fier, sipas së cilës kjo drejtori informon se:

- i. sistemi *TAIS*, ku regjistrohen subjektet që ushtrojnë aktivitet biznesi pranë Bashkisë Fier është në funksion nga viti 2016 dhe përfshin të dhëna nisur nga ky vit;
- ii. kjo drejtori nuk ka arkiv dhe regjistër në të cilën të dokumentoheshin pagesat e taksave për vitet 1993 – 2002;
- iii. tregtarët ambulantë nuk kanë pasur detyrim të regjistrohen në bashki.

37.10.2 Gjithashtu, subjekti me prapësimet e sjella pas dërgimit e rezultateve të hetimit, depozitoi si provë të re deklaratën noteriale⁵⁷ të shtetasit Y.D., për të provuar faktin se babai i tij ka ushtruar aktivitet si tregtar ambulant për periudhën e sipërcituar.

37.10.3 Komisioni, pasi i vlerësoi prapësimet e subjektit me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, si dhe me legjislacionin tatimor të kohës, çmon se nuk do të merren në konsideratë pretendimet e tij lidhur me të ardhura të realizuara nga babai i tij për periudhën 1993 – dhjetor 2002 nga aktiviteti i pretenduar si ambulant, pasi kanë karakter deklarativ dhe nuk janë të bazuara në dokumentacion provues ligjor për vlerën dhe kohën e krijimit të këtyre të ardhurave të pretenduara, si dhe pagesën e detyrimeve përkatëse tatimore.

37.11 Gjithashtu, rezulton se z. M.J., nëpërmjet deklaratës noteriale⁵⁸ ka deklaruar se përgjatë vitit 2010 ka kryer disa punime, si dhe ka blerë disa materiale për apartamentin e tij, në total në vlerën prej 1,700,000 lekësh. Lidhur me këtë fakt, subjekti ka paraqitur si prova deklarata noteriale⁵⁹ dhe disa vërtetime⁶⁰ nga shoqëri të ndryshme nga të cilat pretendohet se ka blerë materialet.

37.12 Bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje dhe në informacione të tjera të përfituara për: (1) të ardhurat e babait, nënës dhe motrës së subjektit, përfshirë dhe të ardhurat nga interesat bankare për periudhën 1996 – 2012; (2) të dhënat nga bankat në lidhje me gjendjen e vlerave monetare në datën 31.12.2012; (3) dokumentacionin për shitblerjet e pasurive të paluajtshme, përfshirë deklaratimet e babait të subjektit të

⁵⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 15.3.2019.

⁵⁵ Referohu shpjegimeve të dhëna nga subjekti në f. 31 - 32, të materialit me titull “Opinione, Sqarime, Prova”, të dërguar nga subjekti i rivlerësimit me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

⁵⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 14.5.2019.

⁵⁷ Deklaratë noteriale me nr. *** , datë 20.5.2019.

⁵⁸ Deklaratë noteriale me nr. *** , datë 28.2.2019, depozituar si provë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.3.2019.

⁵⁹ (1) Deklaratë noteriale me nr. *** , datë 27.2.2019, e shtetasit F.R; dhe (2) deklaratë noteriale me nr. *** , datë 27.2.2019, e shtetasit A.H.

⁶⁰ (1) vërtetim i datës 22.2.2019, nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe; (2) vërtetim i shoqërisë “****” sh.p.k.

rivlerësimit për shpenzime ndërtimi dhe për blerje materialesh për apartamentin; dhe (4) shpenzimeve për konsum vjetor për frymë⁶¹, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë të prindërve të subjektit, për periudhën 1996 – 2012, të pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Analizë për familjen me prindërit 1996 – 31.12.2012

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat nga pensioni, babai i subjektit, 1999 – 2012	2,340,913
Të ardhurat e nënës së subjektit nga puna, 1996 – 2011	4,088,982
Të ardhura e nënës së subjektit nga pensioni, 2011 – 2012	479,721
Te ardhura të motrës së subjektit nga puna (2008 – 2011)	1,277,678
Të ardhura nga shitja e P.Pal datë 28.4.2010	3,450,000
Të ardhura të tjera	1,061,792
Total të ardhura	12,699,086
Pagesat për shpenzime jetese 2000 – 2012 (4 persona 2000 – 2002 dhe pas 2003-shit - 3 persona)	5,226,570
Total shpenzime	5,226,570
Ndryshim mjete monetare banke gjendje fillim - fund periudhe	-3,276,295
Mjete monetare të disponueshme (1)	4,196,221
Pagesa për blerje pasurie të paluajtshme ap.+ garazh, viti deklaruar 2012	4,000,000
Pagesa për shpenzime ndërtimi, deklaruar	1,700,000
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	5,700,000
Balanca e fondeve (1-2)	-1,503,779

37.13 Nga sa më sipër, konstatohet se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara deri në fund të vitit 2012. Theksojmë se në këtë analizë nuk janë përfshirë shpenzime jetese për periudhën 1996 – 1999, për të cilat janë përlogaritur të ardhura.

37.14 Pas kalimit të barrës së provës subjekti dërgoi prapësimet⁶² e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e këtij konstatimi.

38. Pasuri të deklaruar veçmas nga personi i lidhur, znj. R.J.

39. Depozitë në “Veneto Bank”⁶³, e çelur më datë 18.1.2017, me afat 2 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 800,080 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 % në emër të bashkëshortes së subjektit;

⁶¹ Për periudhën 2000 – 2002 (për 4 persona) bazuar në shkresën e INSTAT-it me nr. *** prot., datë 13.2.2006 dhe për periudhën 2003 – 2012 (për 3 persona) vlerat e aplikuara nga ILDKPKI-ja, bazuar në INSTAT.

⁶² Prapësimet e dërguara me e-mail-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

⁶³ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 18.1.2017, për hapje depozite nga znj. R.J., në vlerën 800,080 lekë; data e mbarimit të afatit 18.1.2019; dhe (2) urdhërpagesë e shumës prej 800,080 lekësh, nga znj. R.J., në datën 18.1.2017.

- iii. burimi i krijimit: nga depozita e bankare e mëparshme në vlerën prej 783,387 lekësh + përfitimi i interesave.

39.1 Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

39.1.1 “Intesa Sanpaolo Bank”⁶⁴, si shoqëri përthithëse e “Veneto Bank”, dërgon pranë Komisionit lëvizjet e llogarive të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Veneto Bank”.

39.1.2 Nga verifikimi i këtyre llogarive konstatohet se:

- i. në datën 14.1.2013, znj. R.J., ka derdhur *cash* shumën prej 700,000 lekësh në llogarinë depozitë me nr. ***, në “Veneto Bank”;
- ii. në vazhdimësi, ka përfituar interesa nga kjo depozitë dhe gjendja e saj në datën 16.1.2017 është në shumën 800,080 lekë;
- iii. në datën 18.1.2017, shumën prej 800,080 lekësh e kalon në llogarinë me nr. ***, duke krijuar *depozitë me afat 2-vjeçar*;
- iv. në datën 29.8.2018, të gjitha fondet e kësaj depozite kanë kaluar në llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank” të bashkëshortes së subjektit.

39.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se: (1) deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”; janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri; (2) nuk janë deklaruar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës prej 700,000 lekësh të depozituar *cash*, në janar të vitit 2013; dhe (3) nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite në “Veneto Bank”.

40. Depozitë në “Veneto Bank”⁶⁵, e çelur në datën 31.5.2015, me afat 3 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 895,200 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 % në emër të bashkëshortes së subjektit;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita e bankare e mëparshme në vlerën prej 800,000 lekësh dhe interesat e përfituara.

40.1 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

40.1.1 “Intesa Sanpaolo Bank”⁶⁶, si shoqëri përthithëse e “Veneto Bank”, dërgon pranë Komisionit lëvizjet e llogarive të bashkëshortes së subjektit në “Veneto Bank”.

40.1.2 Nga verifikimi i këtyre llogarive konstatohet se:

- i. në datën 29.8.2013, znj. R.J., ka derdhur *cash* shumën prej 800,000 lekësh në llogarinë depozitë me nr. ***;
- ii. në datën 29.8.2015, ka përfituar interesat në shumën prej 112,000 lekësh, për të cilat është mbajtur tatimi në shumën prej 16,800 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në këtë datë është në vlerën 895,200 lekë;
- iii. në datën 31.8.2015, shumën prej 895,200 lekësh e kalon në llogarinë me nr. 21669, duke krijuar *depozitë me afat 3-vjeçar*;

⁶⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019.

⁶⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): Kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 31.8.2015, për hapje depozite nga znj. R.J. në vlerën 895,200 lekë; data e mbarimit të afatit 31.8.2018.

⁶⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019.

- iv. në datën 29.8.2018, të gjitha fondet e kësaj depozite kanë kaluar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Intesa Sanpaolo Bank”.

40.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se: (1) deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”; janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri; (2) nuk janë deklaruar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës prej 800,000 lekësh të depozituar *cash*, në gusht të vitit 2013; (3) nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite në “Veneto Bank”.

41. Depozitë në “Veneto Bank”⁶⁷, e çelur në datën 29.8.2016, me afat 3 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 782,973 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 % në emër të bashkëshortes së subjektit;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita e bankare e mëparshme dhe përfitimi i interesave.

41.1 Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

41.1.1 “Intesa Sanpaolo Bank”, si shoqëri përthithëse e “Veneto Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019, dërgon pranë Komisionit lëvizjet e llogarive të bashkëshortes së subjektit në “Veneto Bank”.

41.1.2 Nga verifikimi i këtyre llogarive konstatohet se:

- i. në datën 29.8.2013, znj. R.J., ka derdhur *cash* shumën prej 800,000 lekësh në llogarinë depozitë me nr. ***;
- ii. në datën 29.8.2014, ka përfituar interesat në shumën prej 43,400 lekësh, për të cilat është mbajtur tatimi në shumën prej 4,340 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në këtë datë është në vlerën 739,060 lekë;
- iii. po në datën 29.8.2014, shumën prej 739,060 lekësh e kalon në llogarinë me nr. ***, duke krijuar depozitë me afat 2-vjeçar;
- iv. në datën 29.8.2016, ka përfituar interesat në shumën prej 51,663 lekësh, për të cilat është mbajtur tatimi në shumën prej 7,749 lekësh. Gjendja e kësaj llogarie në këtë datë është në vlerën 782,973 lekë;
- v. po në datën 29.8.2016, shumën prej 782,973 lekësh e kalon në llogarinë me nr. ***, duke krijuar depozitë me afat 3-vjeçar;
- vi. në datën 29.8.2018 të gjitha fondet e kësaj depozite, kanë kaluar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”.

41.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se: (1) deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Veneto Bank”; janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri; (2) nuk janë deklaruar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite; dhe (3) nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite në “Veneto Bank”.

⁶⁷ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Kontratë depozite me “Veneto Bank”, e datës 29.8.2016, për hapje depozite nga znj. R.J., në vlerën 782,973 lekësh; data e mbarimit të afatit 29.8.2019; dhe (2) urdhërpagesë e shumës prej 782,973 lekësh nga znj. R.J., datë 29.8.2016.

42. Depozitë në “First Investment Bank”⁶⁸, e çelur në datën 31.8.2015, me afat 2 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 1,482,900 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 % në emër të bashkëshortes së subjektit;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita e bankare e mëparshme prej 1,282,200 lekësh dhe përfitimi i interesave.

42.1 Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri

42.1.1 “First Investment Bank”⁶⁹, informon Komisionin se znj. R.J., (bashkëshortja e subjektit) është regjistruar si kliente e kësaj banke me anë të disa llogarive, nga të cilat vetëm llogaria *Depozitë Dinamike 4x4* është llogari me status aktiv.

42.1.2 Nga verifikimi i këtyre llogarive në “FiBank” konstatohet se gjendja e llogarive rrjedhëse dhe e depozitave në fund të çdo viti, paraqitet në tabelën si më poshtë:

GJENDJA FUNDVITIT	LLOGARITË RRJEDHËSE LEKË	DEPOZITAT LEKË		GJENDJA TOTALE (LEKË)
		DEPOZITA 1 (LEKË)	DEPOZITA 2 (LEKË)	
2010	270,455	2,142,275	1,493,366	3,906,096
2011	573,000	2,275,475	522,335	3,370,810
2012	464,993	2,427,175	0	2,592,168
2013	430,703	2,448,500	0	2,879,203
2014	230,310	1,482,900	0	1,713,210
2015	194,022	1,482,900	0	1,676,922
2016	-200	1,482,900	0	1,482,700

42.1.3 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar saktë shtesat dhe pakësimet e llogarive depozitë, si dhe gjendjet e tyre në fund të vitit.

42.2 Por, konstatohet se personi i lidhur nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse gjendjet e llogarisë rrjedhëse për vitet 2010 dhe 2011.

42.3 Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “First Investment Bank”, konfirmohet se në datën 31.8.2015, nga znj. R.J., është çelur depozita 2-vjeçare dhe se gjendja e kësaj llogarie aktive depozitë përputhet me deklarin e bërë nga bashkëshortja së subjektit.

42.4 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se: (1) deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “FiBank”; janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri; (2) nuk janë deklaruar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite; dhe (3) nuk është paraqitur dokumentacion i plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite në “FiBank”.

⁶⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): (1) Kontratë depozite me “FiBank”, e datës 31.08.2015 për hapje depozite nga znj. R.J., në vlerën 1,482,900 lekë, afati i depozitës 24 muaj; dhe (2) urdhërpagesë e shumës prej 1,482,900 lekësh, nga znj. R.J., datë 31.8.2015.

⁶⁹ Me shkresën nr. ***, datë 11.5.2018.

43. Depozitë në “Bankën Ndërkombëtare Tregtare” (ICB)⁷⁰, e çelur në datën 29.8.2016, me afat 3 vjet:

- i. vlera e deklaruar: 1,352,957 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 % në emër të bashkëshortes së subjektit;
- iii. burimi i krijimit: nga depozita e bankare e mëparshme prej 1,282,200 **lekësh** dhe përfitimi i interesave.

43.1 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

43.1.1 “Internacional Commercial Bank”⁷¹ informon Komisionin se shtetasja R. J., zotëron depozitën aktive në këtë bankë, me vlerë 1,352,957.61 lekë me afat maturimi 36 muaj (29.8.2016 – 29.8.2019).

43.1.2 Nga verifikimi i llogarive të personit të lidhur në “FiBank” konstatohet se gjendja e llogarive/depozitave në fund të çdo viti, paraqitet në tabelën si më poshtë:

GJENDJA FUNDVITIT	DEPOZITAT/ LLOGARITË RRJEDHËSE			GJENDJA TOTALE
	DEPOZITA 1 (EURO)	DEPOZITA 2 (LEKË)	DEPOZITA 3 (LEKË)	
2009	10,000	1,800,000		3,179,600
2010				0
2011		1,000,000		1,000,000
2012		1,400,172		1,400,172
2013		210,140		210,140
2014			1,282,028	1,282,028
2015			1,282,028	1,282,028
2016			1,352,958	1,352,958

43.1.3 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar saktë shtesat dhe pakësimet e llogarive depozitë, si dhe gjendjet e tyre në fund të vitit, që prej vitit 2010⁷² e në vijim.

43.1.4 Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Banka Ndërkombëtare Tregtare” konfirmohet se në datën 29.8.2016, nga znj. R.J., është çelur depozita 2-vjeçare dhe se gjendja e kësaj llogarie aktive depozitë përputhet me deklarinimin e bërë në ILDKPKI.

43.2 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se: (1) deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Banka Ndërkombëtare Tregtare”; janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri; (2) nuk janë deklaruar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite; dhe (3) nuk është paraqitur dokumentacion i plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj depozite në “Bankën Ndërkombëtare Tregtare”.

44. Depozita me vlerë 900,000 lekë

⁷⁰ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): Kontratë depozite me “Bankën Ndërkombëtare Tregtare”, e datës 29.8.2016 për hapje depozite nga znj. R.J., në vlerën 1,352,957 lekë; afati i depozitës, 36 muaj.

⁷¹ Me shkresat nr. *** prot., datë 25.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 30.1.2019.

⁷² Bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e personit të lidhur ka filluar deklarinimet në ILDKPKI në vitin 2010.

44.1 Gjithashtu, “Banka Ndërkombëtare Tregtare” informon Komisionin se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në datën 31.8.2017⁷³, ka çelur depozitën me vlerë 900,000 lekë, me afat maturimi 60 muaj (31.8.2017 – 31.8.2022).

44.2 Komisioni kreu verifikime lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite. Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2017⁷⁴, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar depozitën e re me afat 5 vjet, të hapur në “Bankën Ndërkombëtare Tregtare” në datën 31.8.2017.

44.3 Si burim të krijimit të kësaj depozite ka deklaruar: (1) të ardhurat e përfituara nga tërheqja e shumës prej 600,000 lekësh nga depozita në “FiBank”; (2) nga lekët *cash* të mbetura pas datës 31.12.2016; dhe (3) të një pjese nga të ardhurat nga paga të tërhequra në vitin 2017.

44.4 Nga verifikimi i llogarisë së personit të lidhur në “FiBank”, konfirmohet se në datën 31.8.2018 është tërhequr *cash* shuma prej 600,000 lekësh.

44.5 Në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2016 dhe në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën prej 200,000 lekësh.

44.6 Gjithashtu, nga verifikimi i llogarisë bankare në “BKT”, ku disbursohet paga e personit të lidhur, rezulton se përgjatë vitit 2017, përpara krijimit të kësaj depozite, është tërhequr *cash* në total shuma prej 350,000 lekësh.

44.7 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi i bërë në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2017 përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Banka Ndërkombëtare Tregtare”. Subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

45. Llogari rrjedhëse në “BKT”⁷⁵

45.1 Personi i lidhur ka deklaruar se kjo gjendje llogarie është krijuar si rezultat i mostërheqjes së një pjese të pagës:

- i. vlera e deklaruar: 790,154 lekë;
- ii. pjesa takuese: 100 % në emër të bashkëshortes së subjektit;
- iii. burimi i krijimit: të ardhurat nga paga.

45.2 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

45.2.1 “BKT”-ja⁷⁶, konfirmon se znj. R.J., ka llogari pranë kësaj banke, llogari në të cilën disbursohet paga e saj nga Qendra Shëndetësore ***. Nga verifikimi i kësaj llogarie rezulton se gjendja e saj përputhet me deklarin e bërë nga personi i lidhur në momentin kur ajo është deklaruar.

45.3 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Banka Kombëtare Tregtare”; janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

46. Gjendje *cash*, vlera prej 200,000 lekësh

⁷³ Pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

⁷⁴ Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2019.

⁷⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): Statement nga BKT-ja i datës 20.1.2017.

⁷⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2018.

46.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash*, të cilat, të paktën sipas vetëdeklarimit, justifikojnë krijimin e kësaj gjendjeje në *cash*, deklaruar në deklaratën “Vetting”.

47. Konstatime dhe analizë mbi llogaritë/depozitat/të ardhurat dhe interesat bankare të deklaruar në “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar Vetting”, shtojca 2 nga subjekti dhe personi i lidhur me të

47.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të në deklaratën “Vetting” në rubrikën “*Deklarimi i pasurive*”, përveç deklarimit të pasurive gjendje (depozitave/llogarive bankare), kanë deklaruar dhe depozitat e krijuara ndër vite, historikun e tyre dhe përfitimin e interesave bankare ndër vite.

47.2 Subjekti i rivlerësimit, me deklarimin e pasurive gjendje në momentin e deklarimit, likuiditeteve *cash* dhe në llogari bankare, ka deklaruar burimin fillestar të krijimit të tyre. Ndërsa, personi i lidhur me deklarimin e pasurive gjendje që disponon veçmas, likuiditeteve *cash* dhe në llogari bankare, nuk ka deklaruar burimin fillestar të krijimit të tyre, por i është referuar depozitave të mëparshme.

47.3 Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se për të verifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të personit të lidhur, likuiditeteve *cash* dhe gjendjes në llogari bankare, do të analizohet burimi i krijimit të këtyre pasurive që nga deklarimi fillestar i personit të lidhur, që përkon me deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 të subjektit.

47.4 Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “*deklarimi i pasurive*”, personi i lidhur, gjithashtu, ka deklaruar si pasuri edhe:

- i. vlerën prej 13,000 eurosh, përfituar nga marrëveshja verbale për ndërmjetësim dhe përfaqësim për blerje banese për llogari dhe interes të z. S.K., dhe znj. A.K., (tezja e saj), realizuar në vitin 2007;
- ii. vlerën prej 1,000,000 lekësh, dhuruar nga z. S.K., dhe znj. A.K., në vitin 2002, për të përballuar ndjekjen e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë Tiranë.

47.5 Komisioni vlerëson se: (1) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë duke deklaruar si pasuri të ardhurat nga interesat bankare; (2) personi i lidhur ka kryer deklarim të pasaktë duke deklaruar si pasuri të ardhurat nga interesat bankare dhe të ardhurat e dhuruara apo të përfituara nga tezja e saj, znj. A.K dhe bashkëshorti i saj, z. S. K.

47.6 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, personi i lidhur me deklarimin e pasurive që zotëron veçmas nga subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të tyre:

- i. të ardhurat nga puna si mjeke (të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet);
- ii. të ardhurat e përfituara nga marrëveshja e vitit 2006 për blerjen e apartamentit;
- iii. të ardhurat e përfituara nga interesat bankare.

47.7 Konstatohet se personi i lidhur në deklarimin fillestar nuk ka deklaruar si burim krijimi të pasurive vlerën prej 1,000,000 lekësh të pretenduar si të dhuruar nga tezja e saj në vitin 2002. Nisur edhe nga vetëdeklarimet e bëra nga personi i lidhur⁷⁷ dhe të z. S. K.⁷⁸

⁷⁷ Deklarata noteriale nr. ***, datë 31.12.2018.

⁷⁸ Deklaratë datë 28.12.2008 dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.10.2014.

(bashkëshorti i tezes së saj), Komisioni vlerëson se këto të ardhura kanë shërbyer për shpenzimet e shkollimit të znj. R.M.(Jaupaj) për periudhën 2002 – 2005. Si rrjedhim, Komisioni çmon se në analizën financiare nuk do të përllongariten këto të ardhura si të ardhura, të cilat mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të personit të lidhur.

47.7.1 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe lënies së barrës së provës, subjekti, në prapësimet⁷⁹ e tij, pretendoi se një pjesë e këtyre të ardhurave kanë shërbyer për krijimin e pasurive (depozitave) nga personi i lidhur në fund të vitit 2009. Ky pretendim nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, pasi ka karakter deklarativ dhe nuk është i bazuar në prova.

47.8 Gjithashtu, personi i lidhur, në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2010 dhe në deklaratën “Vetting” ka deklaruar përfitimin e shumës prej 13,000 eurosh në vitin 2007, nga marrëveshja verbale për ndërmjetësim dhe përfaqësim për blerje banese për llogari dhe në interes të shtetasve S., dhe A.K.

47.9 Rezulton se në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2010, personi i lidhur ka deklaruar pasurinë e paluajtshme, **apartament banimi 1+1, i pahipotekuar, i ndodhur në Tiranë:**

- i. vlera e deklaruar: 52,000 euro;
- ii. pjesa takuese: 100 % në emër të bashkëshortes së subjektit;
- iii. burimi i krijimit: ka deklaruar se është blerë për llogari të shtetasit S.K., pra, me të ardhurat e tij.

47.10 Personi i lidhur pretendon se në muajin maj të vitit 2006 i është kërkuar nga znj. A.K., dhe z. S. K., të blejë për llogari dhe interes të tyre, një apartament në qytetin e Tiranës, pasi ata banonin dhe punonin në Greqi dhe nuk mund ta kryenin vetë këtë veprim. Personi i lidhur deklaroi se nuk kanë bërë një akt-përfaqësimi por një marrëveshje verbale, sipas së cilës blerja në fillim do të kryhej në emrin e saj, por për llogari dhe interes të tyre, dhe se më pas do të kryhej procedura për kalimin e pronësisë në emrin e tyre. Personit të lidhur i është dhënë në dorë shuma prej 65,000 eurosh, për blerjen e apartamentit, i cili duhej të plotësonte disa kriteret. Gjithashtu, sipas tyre, marrëveshja parashikonte se në rast se apartamenti do të blihej në një vlerë më të ulët, personit të lidhur, znj. R.M., (Jaupaj), do t'i kalonte në pronësi diferenca e çmimit, pas miratimit të znj. A.K., dhe bashkëshortit të saj, me kushtin që ajo të përkujdesej për këtë apartament deri në ardhjen e tyre.

47.11 Në vijim, znj. R.M., (Jaupaj), deklaroi se ka lidhur kontratën me nr. ***, datë 26.3.2007, nëpërmjet së cilës ka blerë, sipas vetëdeklarimit formalisht në emrin e saj, apartamentin 1+1, me sip. 68.2 m², ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, për vlerën prej 52,000 eurosh. Sipas vetëdeklarimeve, pasi u miratua dhe u krye blerja e këtij apartamenti,

⁷⁹ Prapësimet e dërguara me e-mail-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

diferenca e shumë pas blerjes, në vlerën 13,000 euro, i kaloi personit të lidhur në pronësi që në momentin e blerjes së apartamentit, në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes⁸⁰.

47.12 Në këtë kontratë parashikohet se z. G.Gj., në bazë të kontratës noteriale nr. ***, datë 26.3.2007, ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin Tip**** (kulla ***), me sipërfaqe ndërtimi në total 68.2 m², në katin e tretë nga toka, me orientim jug-lindje, në kompleksin ndodhur në Rr. “****”, i cili ndërtohet në pronën e z. A.L. Z. G.Gj., deklaron se apartamentin e përshkruar më sipër ia ka shitur znj. R.M., për shumën prej 52,000 eurosh. Kësaj kontrate i bashkëngjitet kontrata e shitjes me rezervë, lidhur ndërmjet shoqërisë ndërtuese dhe z. G.Gj.

47.13 Nga dokumentacioni i administruar në dosje konstatohet se në datën 23.3.2007 shtetasi G.Gj, nëpërmjet kontratës së shitjes me rezervë me nr. *** prot., ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin e përshkruar më sipër, për vlerën prej 52,000 eurosh.

47.14 Komisioni i kërkoi⁸¹ ZVRPP-së Tiranë referencën e plotë të kësaj pasurie. Nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë nga ZVRPP-ja rezulton se znj. A.K., nëpërmjet kontratës së shitjes me nr. ***, datë 22.10.2015, të redaktuar nga notere M.D., ka blerë nga shoqëritë “****” sh.p.k., dhe “****” sh.p.k., apartamentin objekt hetimi. Vërehet se, në nenin 5, të kësaj kontrate “Mënyra e pagesës”, shitësi deklaron se blerësi e ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme, shumën prej 43,260 eurosh, sipas kontratës së shitjes me rezervë me nr. ***, datë 23.3.2007. Por, kontrata e shitjes me rezervë nuk gjendet në dosjen e kësaj pasurie.

47.15 Nisur nga të dhënat e mësipërme, Komisioni i kërkoi⁸² noteres M.D., kopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 22.10.2015 dhe dokumentacionin shoqërues të saj. Noterja M.D.,⁸³ dërgon në Komision praktikën e plotë të mbajtur për kontratën e shitjes të redaktuar nga ajo, lidhur mes shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., në cilësinë e subjekteve shitës dhe znj. A.K, në cilësinë e blerëses. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar, ndër të tjera, rezulton se në datën 23.3.2007, shtetasja A.K., ka lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., kontratën e shitjes me rezervë me nr. *** prot. Referuar kësaj kontrate rezulton se znj. A.K., ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., të njëjtin apartament, të cilin sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti rivlerësimit dhe vetëdeklarimeve të bëra nga znj. R.M. (Jaupaj), kjo e fundit e kishte blerë në datën 26.3.2007 nga shtetasi G.Gj. Gjithashtu, në këtë kontratë parashikohet se palët kanë rënë dakord se çmimi i shitjes së apartamentit është 42,260 euro dhe se blerësi e ka paguar këtë shumë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

47.16 Pra, nga dokumentacioni i administruar rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., në datën 23.3.2007, ka nënshkruar dy kontrata shitjeje me rezervë, me objekt shitjeje të njëjtin pasuri. Këto kontrata ndryshojnë nga: (1) palët blerëse; (2) numri i protokollit; dhe (3) çmimi i përcaktuar në nenin 3, të kontratës, ndërsa elementet e tjera të kontratës janë të njëjta.

⁸⁰ Referohu deklaratës noteriale nr. ***, datë 31.12.2018, administruar si provë në dosjen e subjektit.

⁸¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2019.

⁸² Me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2019.

⁸³ Me shkresën e datës 18.2.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.2.2019.

47.17 Në vijim të veprimeve hetimore lidhur me këtë pasuri, Komisioni i kërkoi⁸⁴ shoqërisë “***” sh.p.k. të konfirmojë nëse kemi të bëjmë me dy kontrata të ndryshme, me objekte të ndryshme, apo të njëjtën pasuri objekt shitjeje në të dyja kontratat. Shoqëria “***” sh.p.k. informon⁸⁵ se ajo, së bashku me shoqërinë “***” sh.p.k., në datën 22.10.2015, kanë lidhur kontratë shitjeje me znj. A.K., për apartamentin Tipi ***, Kulla ***, me sipërfaqe 61.2 m² (sipërfaqe totale 68.2 m²), bazuar në kontratën e shitjes me rezervë të datës 23.3.2007, me nr. 139 prot. Gjithashtu, shoqëria informon se, me z. G.Gj., është lidhur kontratë shitjeje me rezervë me nr. *** prot., por në të njëjtën ditë kjo kontratë është revokuar me një deklaratë nga z. G.Gj. Si rrjedhim, duke qenë se apartamenti ishte i lirë, iu shit në të njëjtën datë znj. A.K. Për sa i përket çmimit të shitjes, shoqëria shpjegon se është marrëveshje mes dy palëve. Pra, shoqëria “***” sh.p.k. konfirmon se në datën 23.3.2007 i ka shitur znj. A.K., apartamentin objekt hetimi, për vlerën prej 42,260 eurosh.

47.18 Nga sa më sipër, Komisioni konstaton se: (1) personi i lidhur nuk ka pasur asnjë akt përfaqësimi që të justifikojë prenotimin e kësaj pasurie për llogari të shtetasve A., dhe S.K.; (2) nuk disponohet dokumentacioni ligjor në lidhje me dërgimin e vlerës prej 65,000 eurosh nga z. S.K., për blerjen e apartamentit; (3) nuk ka asnjë dokument që të provojë kalimin e të drejtave reale mbi këtë pasuri nga shtetasja R.M., (Jaupaj) në favor të shtetasve A., dhe S.K.; (4) ky apartament është prenotuar fillimisht nga znj. A.K., në datë 23.3.2007, për vlerën prej 42,260 eurosh.

47.19 *Si përfundim, Komisioni çmon se nuk qëndrojnë pretendimet e personit të lidhur se ka përfituar shumën 13,000 euro nga marrëveshja verbale për ndërmjetësim dhe përfaqësim për blerje e këtij apartamenti, pretenduar si i prenotuar nga personi i lidhur, znj. R.M., (Jaupaj), në datën 26.3.2007.*

47.20 Pas kalimit të barrës së provës subjekti dërgoi prapësimet⁸⁶ e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse. Subjekti dokumentoi⁸⁷ se shtetasja A.K., nuk ka qenë në Shqipëri në datën 23.03.2007, datë e cila përkon me datën kur është lidhur kontrata e shitjes me rezervë në emër të saj me shoqërinë “***” sh.p.k. për prenotimin e këtij apartamenti. Por gjithsesi, nisur nga çmimi përfundimtar i blerjes së këtij apartamenti dhe faktit se nuk disponohet dokumentacion ligjor lidhur me dërgimin e vlerës së pretenduar prej 65,000 eurosh nga shtetasi S.K., dhe, pasi Komisioni pasi i vlerësoi me objektivitet dhe me paanësi të gjitha provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e këtij konstatimi.

48. Analizë për treguesit financiarë të personit të lidhur, znj. R.M.(Jaupaj), bashkëshortja e subjektit, për periudhën deri në datën 31.12.2009

⁸⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2019.

⁸⁵ Me shkresën e datës 27.3.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.3.2019.

⁸⁶ Prapësimet e dërguara me e-mail-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

⁸⁷ Depozitoi si provë me prapësimet e dërguara me e-mail-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019: (1) pasaportën me nr. *** të shtetasës A. K.; (2) pasaportën nr. *** të shtetasit S.K., dhe; (3) shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

48.1 Referuar Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2010 dhe dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se sipas certifikatës së martesës në këtë vit, në datën 16.9.2010, subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, ka lidhur martesë me znj. R.M.

48.2 Në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2010 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar se në datën 31.12.2010 zotëronte veçmas këto pasuri:

- i. depozitë në “First Investment Bank”, në vlerën prej 2,142,275 lekësh;
- ii. depozitë në “First Investment Bank”, në vlerën prej 1,493,366 lekësh;
- iii. gjendje llogarie rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në vlerën prej 135,091 lekësh;
- iv. apartament 1+1, blerë në Tiranë në vitin 2007 nga dhe në emër të R.M.,(Jaupaj) për llogari dhe interes të shtetasit S.K., i pahipotekuar, me vlerë 52.000 euro.

48.3 Referuar të dhënave nga llogaritë bankare të personit të lidhur rezulton se në datën 16.9.2010 dhe në datën 31.12.2010 bashkëshortja e subjektit ka pasur gjendje në llogari, si më poshtë:

Banka	Gjendjet e llogarive në datën 16.9.2010, në lekë	Gjendjet e llogarive në datën 31.12.2010, në lekë
Raiffeisen Bank	145,088	135,095
FI Bank	160,985	270,455
FI Bank	592	2,142,275
FI Bank	27	1,493,366
Totale	306,692	4,041,191
Shtesë vlera monetare		3,734,499

48.4 Nisur nga sa më sipër, konstatohet se: (1) në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2010, personi i lidhur nuk ka deklaruar gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “First Investment Bank” me vlerë 270,455 lekë; dhe (2) gjendjet e llogarive të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, nga data e lidhjes së martesës (16.9.2010), deri në fund të vitit 2010 janë rritur me 3,734,499 lekë.

48.5 I pyetur nga Komisioni nëse para celebrimit të martesës ka ekzistuar bashkëjetesë në kuptim të nenit 163, të Kodit të Familjes, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëjetesa e tij me znj. R.M., (Jaupaj) ka filluar në muajin janar të vitit 2010.

48.6 Referuar të dhënave nga sistemi TIMS rezulton se subjekti i rivlerësimit, së bashku me znj. R.M.,(Jaupaj), sot bashkëshortja e tij, kanë dalë së bashku nga Shqipëria në datën 28.7.2009 dhe kanë hyrë në datën 7.8.2009 (udhëtim me charter). Lidhur me këtë udhëtim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *destinacioni ka qenë për pushime verore, paketë ofertë së bashku me udhëtimin përfshirë, me të fejuarën (të njohurën) R.M, por shpjegon se në atë kohë akoma nuk kishte filluar bashkëjetesa midis tyre.*

48.7 Gjithashtu, referuar të dhënave të “Raiffeisen Bank” konstatohet se në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes së subjektit, në datën 10.6.2009 është derdhur shuma prej 240,000 lekësh nga znj. L.J., e motra e subjektit të rivlerësimit. Lidhur me këtë shumë, subjekti ka deklaruar: “... janë të ardhura të bashkëshortes që më parë i ishin dhënë shtetasve S., dhe A.K., për blerjen e disa pajisjeve mjekësore, para të cilat ia kanë kthyer nëpërmjet një të njohuri, shofer i linjës Athinë-Fier, i cili i dorëzonte paratë në Fier. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në atë kohë ai me znj. R.M., (Jaupaj) kishin pak që ishin

fejuar dhe R., kishte filluar vizitat në shtëpinë e tij. Për këtë arsye, thotë se R., kishte biseduar me tezen e saj që paratë do t'i merrte në Fier. Duke qenë se kishte një ngatërresë me shoferin që do të sillte paratë, ato nuk erdhën në fundjavën që R., ishte aty, por fundjavën tjetër, dhe se, pas bisedës me motrën e tij, ranë dakord që kjo e fundit t'i konvertonte dhe t'ia derdhte në llogari bankare R.”

48.8 Komisioni kreu analizë financiare lidhur me mundësinë e krijimit të vlerave monetare (likuiditeteve) që bashkëshortja e subjektit në datën 31.12.2009, zotëronte në llogaritë e saj bankare.

48.9 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje rezulton se në datën 31.12.2009, personi i lidhur ka pasur gjendje të evidentuar në llogari bankare vlerën prej 3,321,748 lekësh dhe konkretisht, të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Banka	Gjendje në datën 31.12.2009 (në lekë)
Raiffeisen Bank	142,138
BKT	10
ICB	1,800,000
ICB (10.000 eu)	1,379,600
Total	3,321,748

48.10 Të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet e personit të lidhur për periudhën 2005 – 31.12.2009, të vërtetuara me dokumentacion, janë në vlerën 1,697,011 lekë, ndërsa të ardhurat nga interesat bankare janë në vlerën 114,604 lekë .

48.11 Analiza financiare lidhur pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur për periudhën 2005 – 31.12.2009 (pa përfshirë blerjen e apartamentit në Tiranë, të cilin deklaroi se nuk është i saj), paraqitet si më poshtë:

Analiza financiare, znj. Renata Malaj, periudha 2005 – 31.12.2009	Vlera në lekë
Të ardhura nga paga	1,697,011
Të ardhura interesa BKT	114,604
Total Të ardhura	1,811,615
Shpenzime pushime Turqi viti 2009, deklaruar 800 euro	110,368
Pagesa interesa kredie “Raiffeisen Bank”, periudha 2006 – 2009	203,678
Pagesat për shpenzime jetese, 1 person	618,765
Total shpenzime	932,811
Ndryshim mjete monetare banke gj. fillim – gj. fund periudhe	-3,321,748
Mjete monetare të disponueshme (1)	-2,442,944
Pagesa për blerje pasurie	0
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	0
Balanca e fondeve (1-2)	-2,442,944

48.12 Nga sa më sipër, konstatohet se personi i lidhur ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kursimet e krijuara gjendje në llogari bankare në fund të vitit 2009.

48.13 Pas kalimit të barrës së provës subjekti dërgoi prapësimet⁸⁸ e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se nuk arriti të provojë të kundërtën e këtij konstatimi.

49. Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

49.1 Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror për këtë subjekt, konstaton se:

- i. subjekti, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive;
- ii. ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me pasuritë në përdorim nga ai;
- iii. ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e disa depozitave dhe llogarive bankare në emrin e personit të lidhur me të;
- iv. subjekti ka përfituar trajtim preferencial në kundërshtim me nenet 23 dhe 24, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

49.2 Lidhur me pasaktësitë e konstatuara në mosdeklarimin e gjendjeve të llogarive bankare në fund të vitit, në disa deklarime periodike vjetore, Komisioni, çmon se duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, këto deklarime të pasakta nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

49.3 Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe në të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe në provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

1. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara.
2. Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.
3. Gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

50. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

50.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin⁸⁹ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, ku ka konstatuar se:

⁸⁸ Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

⁸⁹ Me nr. *** prot., datë 27.10.2017.

- i. formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për Kontrollin e Figurës;
- iii. për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar;
- iv. në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj.

Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 17.10.2018.

51. Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

51.1 Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

51.2 *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.*

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

52. Raporti nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

52.1 Ky raport është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

52.2 Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin: (1) e formularit të vetëdeklarimit; e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti; si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti; (2) e pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) e të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

52.3 Në raport analizohen të dhënat nga dokumentet duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

52.4 Saktësia e formularit të vetëdeklarimit: Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti konstatohet se formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës të ligjit. Formulari nuk ka mangësi apo kundërthënie në përmbajtje.

52.5 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit: gjatë viteve 2014, 2015, 2016, rezultojnë se subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit vendim gjyqësor, nga të cilat dy vendime për çështje civile themeli dhe një vendim për çështje penale themeli.

52.6 Pesë dosjet e përzgjedhura me short: në datën 6.3.2018, ora 10:30, në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në prani të inspektorit të Inspektoratit të KLD-së dhe të anëtarëve të Komisionit, u përzgjedhën me short pesë dosje. Nga shorti i hedhur ka rezultuar se u përzgjedhën në mënyrë rastësore dy vendime për çështje civile themeli, dy vendime për çështje penale themeli dhe një vendim për masë sigurimi në proces penal.

52.7 Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së: sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, janë paraqitur dy ankesa (në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së. Të dyja këto ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore ndaj gjyqtarit Roland Jaupaj.

53. Analiza e gjetjeve

53.1 Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLD.

53.2 Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, tri vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitura në raportin e plotë të mbajtur nga Inspektorati i Lartë i KLD-së⁹⁰, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitura në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

54. Aftësitë profesionale

54.1 Njohuritë ligjore

54.1.1 Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për zbatimin e saj në rastin konkret. Gjithashtu, evidentohet se analizojnë normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ka njohuri të procedurës së gjykimeve civile, si dhe të gjykimeve penale me procedurë të zakonshme apo të shkurtuar.

⁹⁰ Raporti nr. *** prot., datë 23.4.2018, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj”.

54.2 Arsyetimi ligjor

54.2.1. Referuar raportit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor të një niveli mesatar. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij janë të thjeshta, të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar në formë unike, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal apo kërkesat e legjislacionit procedural civil. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

54.2.2 Gjithashtu, te të pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se *jo në çdo rast ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, duke referuar saktë shkakun dhe bazën ligjore*. Në disa raste janë konstatuar mangësi në këtë drejtim (shihni dosjet 2, 4 dhe 5).

55. Aftësitë organizative

55.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

55.1.1 Bazuar në të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe analiza e kryer nga Inspektorati i Lartë i KLD-së konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarit Roland Jaupaj ka qenë mbi standardin sasior.

55.1.2 Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve, konstatohet se ndër pesë dosjet e vëzhguara, vetëm në një rast është konstatuar tejkalimi i afatit standard të gjykimit me 4 ditë (shihni dosjen nr. 4). Ndërsa, nga analiza e tri dokumenteve të dorëzuara nga subjekti është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në të tria rastet brenda afateve standard të gjykimit.

55.1.3 Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se subjekti i kushton rëndësi të veçantë arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Ndër pesë dosjet e vëzhguara, asnjë vendim nuk është arsyetuar jashtë afatit ligjor.

55.1.4 Duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal, ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesa vendimet gjyqësore.

55.2 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

55.2.1 Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim duke qenë efektiv në përfundimin në kohë të tyre.

55.2.2 Në dy çështje civile të vëzhguara janë kryer veprimet përgatitore dhe janë dokumentuar rregullisht, por nuk janë kryer me përpikëri sipas kërkesave të nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile dhe rrjedhimisht, nuk i kanë shërbyer efektivitetit të gjykimit (shihni dosjet 1 dhe 2).

55.2.3 Gjyqtari Roland Jaupaj i kushton rëndësi kërkesave procedurale të palëve dhe jep urdhra dhe vendime për zgjidhjen e tyre. Orienton drejt debatit gjyqësor duke ndjekur

procedurën e parashikuar nga ligji, deri në shpalljen e vendimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

55.2.4 Në një çështje penale është konstatuar se ka shtyrë seancën e gjykimit të shkurtuar për të marrë në shqyrtim prova (shihni dosjen 5), në shkelje të nenit 404, të Kodit të Procedurës Penale. Në një çështje tjetër penale është konstatuar se gjykata nuk ka marrë masat për të disiplinuar sjelljen e mbrojtësit në gjykim për të eliminuar taktikat vonuese të tij (shihni dosjen 4).

55.2.5 Ndër 5 dosjet e vëzhguara, 2 çështje janë përfunduar me 5 seanca (shihni dosjet 2 dhe 5), 1 çështje me 1 seancë (shihni dosjen 3), 1 çështje me 7 seanca (shihni dosjen 1) dhe 1 çështje me 20 seanca (shihni dosjen 4). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 38 seanca të zhvilluara prej gjyqtarit Roland Jaupaj, nga të cilat 21 kanë qenë produktive. Pengesë në 17 seanca joproduktive ka qenë mosplotësimi i të metave të padisë nga paditësi (1 seancë), njoftimi i palëve (2 seanca), mosinformimi i trupit gjykues (5 seanca), mosparaqitja e mbrojtësit (7 seanca), kërkesa e mbrojtësit për t'u konsultuar me të pandehurin (1 seancë) dhe mospërgatitja e prokurores për diskutimin përfundimtar (1 seancë).

55.2.6 Janë konstatuar 2 seanca penale të caktuara përtej afatit 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale (shihni dosjet 4 dhe 5), ku bie në sy një seancë penale për diskutimin përfundimtar e caktuar pas 2 muajve dhe që nuk justifikohet as me lejen vjetore të gjyqtarëve (shihni dosjen 5).

55.2.7 Seancat përgatitore janë zhvilluar në zyrë dhe nuk është dokumentuar orari i tyre (shihni dosjet 1 dhe 2), ndërsa seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë dokumentuar edhe me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit të gjykimit (shihni 5 dosjet).

55.2.8 Janë mbikëqyrur aktet e njoftimit pa pasur vonesa në kryerjen e tyre, dhe në 4 dosje të vëzhguara nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të njoftimeve. Në dosjen 2 ka pasur dështim të 2 seancave për shkak të njoftimeve.

55.2.9 Lidhur me aftësitë e subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, për të kryer procedurat gjyqësore duhet evidentuar se ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, në asnjë rast gjykatat më të larta nuk kanë konstatuar gabime gjyqësore të tij, me pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

55.3. Aftësia për të administruar dosjet: Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota.

55.3.1 Në një çështje është konstatuar se mungon akti i përfaqësimit të të paditurit (shihni dosjen 1), ndërsa në një dosje nuk janë përfshirë dokumentet justifikuese të mungesës së gjyqtarëve dhe të mbrojtësit, të relatuar në procesverbal (shihni dosjen 4). Vendimet e ndërmjetme nuk janë fiksuar gjithnjë në procesverbal me arsyetim e shkak ligjor (shihni dosjet 2, 4 dhe 5).

56. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

56.1 Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punën të gjyqtarit Roland Jaupaj. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

56.2 Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

56.3 Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Me përjashtim të mangësive procedurale të përshkruara tek Aftësitë Organizative, nuk janë konstatuar shkelje procedurale që cenojnë standardin e gjykatës së paanshme.

57. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

57.1 Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Roland Jaupaj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

57.2 Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna të drejtpërdrejta mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt, duhet evidentuar se ka pasur 17 seanca gjyqësore joproductive apo të dështuara nga planifikimi, 5 nga të cilat për mungesë të anëtarit të trupit gjykues për arsye shëndetësore, por në dosje nuk ka dokumente justifikuese. Nga ana tjetër, nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

57.3 Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Roland Jaupaj ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 20 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ka marrë pjesë në 34 ditë trajnim gjithsej për tre vjet. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, duke përfshirë edhe tema për funksionin e kryetarit të gjykatës.

58. Denoncimet e publikut të depozituara në Komision

58.1 Mbi denoncimet e ardhura në Komisionin për subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj

59. Denoncimet nr. *** prot., datë 12.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 23.1.2019

59.1 Denoncuesja, znj. L.Z., denoncon ndër të tjerë, subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për dhënie vendimi në kundërshtim me ligjin. Denoncuesja, nëpërmjet këtyre dy denoncimeve denoncon se janë dhënë vendime në kundërshtim me Kodin Penal dhe se gjyqtarët e denoncuar kanë shkelur etikën në gjykimin e çështjes, ku djali i saj, z. O.T., ka qenë i pandehur dhe është gjykuar e dënuar për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga germa “dh”, e nenit 79, e Kodit Penal.

59.2 Përshkrimi i procesit gjyqësor

59.2.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 03.02.2014 ka vendosur: (i) të deklarojë fajtor të pandehurin O.T., për veprën penale “vrasje në rrethana cilësuese” dhe në bazë të nenit 79/dh të Kodit Penal ta dënojë me 25 vjet burgim; (ii) të deklarojë fajtor të pandehurin O.T., për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal ta dënojë me 2 vjet burgim; dhe (iii) në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55/1,2 të Kodit Penal të dënojë përfundimisht të pandehurin O. T., me 25 vjet burgim.

59.2.2 Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 1.7.2014, ka vendosur: - Prishjen e vendimit nr. ***, datë 3.2.2014, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

59.2.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendimin nr. ***, datë 1.7.2014, ka vendosur: (i) deklarojë fajtor të pandehurin O.T., për veprën penale “vrasje në rrethana cilësuese” dhe në bazë të nenit 79/dh të Kodit Penal ta dënojë me 25 vjet burgim; (ii) të deklarojë fajtor të pandehurin O.T., për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal ta dënojë me 2 vjet burgim; dhe (iii) në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55/1,2 të Kodit Penal të dënojë përfundimisht të pandehurin O.T., me 25 vjet burgim.

59.2.4 Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 10.11.2015, ka vendosur: - Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 1.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

59.2.5 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë 15.12.2016, ka vendosur: Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i pandehuri O.T, kundër vendimit nr. ***, datë 10.11.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

59.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga denoncuesi, nuk rezulton që subjekti Roland Jaupaj, të ketë qenë pjesë e trupave gjyqësore që kanë gjykuar çështjen në themel. Edhe në denoncimin e bërë nuk evidentohet roli i subjektit të rivlerësimit dhe pretendime konkrete për shkelje procedurale/etike në adresë të tij.

59.4 Gjithashtu rezulton se, nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e subjektit Roland Jaupaj konstatojmë se znj. L.Z., për të njëjtën çështje, ka paraqitur ankesën e saj pranë Inspektoratit të KLD-së⁹¹. Konstatohet se, pretendimet ndaj gjyqtarit Roland Jaupaj lidhen me caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit O. T.

⁹¹ Me nr. *** prot., datë 26.02.2015.

59.5 Në datën 31.7.2012, gjyqtari Roland Jaupaj e ka vendosur vleftësimin e arrestit në flagrancë ndaj të arrestuarit O.T., si të ligjshëm. Nuk kemi të dhëna nëse ndaj këtij vendimi është kryer ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë.

59.6 Për sa më sipër Komisioni vlerëson se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin, z. Roland Jaupaj.

60. Denoncimi nr. *** prot., datë 5.1.2018

60.1 Denoncuesi, z. F.B., denoncon ndër të tjerë edhe subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për marrjen e një vendimi në kundërshtim me ligjin. Denoncohet ky gjyqtar për marrje vendimi të padrejtë, të pambështetur në prova dhe fakte, lidhur me pronësinë e një pasurie. Denoncuesi pretendon se vendimi është dhënë kundërshtim me ligjin, për të favorizuar palën kundërshtare.

60.2 Vendimet e marra nga gjykatat lidhur me çështjen objekt ankimi

60.2.1 Trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përbërje të të cilit ishte edhe gjyqtari Roland Jaupaj me vendimin nr. ***, datë 15.1.2015 me: (i) paditës: F.B., dhe të tjerë; (ii) të paditur: V.DH.,(P)... etj. dhe me (iii) objekt: ndryshim i aktit administrativ, vendim nr. ***, datë 13.10.1994, të KKK të Pronave Fier dhe ndryshim i aktit administrativ, vendim nr. ***, datë 13.10.1994, të KKK të Pronave Fier; ka vendosur: rrëzimin e padisë tërësisht për secilin nga paditësit F.B., dhe të tjerë.

60.2.2 Gjykata e Apelit Vlorë, e përbërë nga trupi gjykues me 3 gjyqtarë me vendimin nr. ***, datë 6.11.2018, me shumicë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** , datë 13.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

60.2.3 Nga verifikimi i faqes zyrtare të web-it të Gjykatës së Lartë konstatohet se për këtë çështje civile është ushtruar rekurs dhe pritet shqyrtimi i saj në këtë gjykatë.

60.3 Nga shqyrtimi i këtij denoncimi vërehet se denoncuesi nuk paraqiti asnjë rrethanë apo provë konkrete që të lidhte subjektin e rivlerësimit me veprime korruptuese, me shkelje të etikës së gjyqtarit apo me shkelje procedurale të kryera gjatë gjykimit.

60.4 Për sa i përket pjesës së denoncimit që ka të bëjë me vendimmarrjen, Komisioni vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: *vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit çmohet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si edhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën që vlerësohet.*

60.5 Nisur nga sa më sipër Komisioni çmon se, nuk mund të komentohet një vendim gjyqësor apo zgjidhja e dhënë prej tij, për sa kohë ky vendim është në fuqi dhe nuk është prishur nga një gjykatë më e lartë dhe aq më pak të ngarkohen me përgjegjësi gjyqtarët që e kanë dhënë këtë vendim. Ky argument bazohet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese e cila me vendimin nr. 11, datë 27.5.2004, ka sanksionuar detyrimin sipas të cilit: *“Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga një gjykatë më e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund*

të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.

61. Denoncimi nr. *** prot., datë 5.1.2018

61.1 Denoncuesi, z. L.B., denoncon ndër të tjerë (gjithsej 22 subjekte rivlerësimi), edhe subjektin Roland Jaupaj me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për procese jo të rregullta gjyqësore, shkelje ligjore. Denoncuesi ngre pretendime për disa procese gjyqësore civile dhe penale, në të cilat ai ka qenë palë dhe i pandehur. Ai pretendon për zvarritje të këtyre proceseve gjyqësore, se ato janë kryer në mungesë të tij dhe vendimet janë marrë po në mungesë të tij.

61.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga denoncuesi rezulton se subjekti Roland Jaupaj ka qenë pjesë e trupit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili ka pasur në gjykim të pandehurin L.B.

61.3 Përshkrimi i procesit gjyqësor

61.3.1 Konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në diskutimin përfundimtar kërkoi deklarin përfundimtar të të pandehurit L.B., për veprën penale “mashtrim” dhe në bazë të nenit 143/2, të Kodit Penal kërkoi dënimin e tij me 11 vjet burgim.

61.3.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 10.3.2008, ka vendosur: të deklarojë fajtor të pandehurin L.B., për veprën penale “mashtrim” dhe në bazë të nenit 143/1 të Kodi Penal, ta dënojë atë më 4 vjet burgim. Dosja me të pandehur L.B., është regjistruar në datën 16.5.2007. Gjithashtu në vendimit thuhet se i pandehuri dhe mbrojtësi i tij në konkluzionet përfundimtare nuk pranuan fajësinë, me arsyetimin se akti përbën një detyrim civil dhe jo veprë penale.

61.3.3 Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 30.9.2009, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 10.3.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe duke e gjykuar çështjen në fakt: të deklarojë fajtor të pandehurin L.B., për veprën penale “mashtrim” që ka sjellë pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite ta dënojë me 10 vjet burgim.

61.3.4 Nga verifikimi i faqes zyrtare të web-it të Gjykatës së Lartë konstatohet se për këtë çështje civile është ushtruar rekurs dhe se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 30.9.2009, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

61.3.5 Lidhur me këtë proces gjyqësor penal, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues, denoncuesi ka paraqitur vetëm vendimin e gjykatës nga i cili vërehet se gjykimi ka zgjatur për rreth 10 muaj dhe i pandehuri/mbrojtësi i tij kanë qenë i pranishëm në momentin e dhënies së vendimit duke paraqitur konkluzione përfundimtare.

61.3.6 Për sa më sipër Komisioni vlerëson se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj.

62. Denoncimi nr. *** prot., datë 20.12.2018

62.1 Denoncuesi, z. H.G., denoncon subjektin e rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për dhënie vendimi në kundërshtim me ligjin. Denoncohet se gjyqtari Roland Jaupaj me dashje ka bërë shkelje ligjore, pasi nuk e ka gjykuar fare çështjen në themel, por e ka zvarritur gjykimin qëllimisht dhe e ka favorizuar palën e paditur duke dhënë vendimin në favor të tyre.

62.2 Nga verifikimi i këtij denoncimi rezulton se kemi të bëjmë me të njëjtën çështje, të denoncuar nga shtetasi F.B.⁹², trajtuar si më lart. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga denoncuesi rezulton se kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 15.1.2015 dhe se kjo gjykatë e ka shpallur vendimin në datën 13.10.2016.

62.3 Pra, kjo çështje ka zgjatur rreth 19 muaj, në intervalin kohor 15.1.2015 – 13.10.2016. Në dokumentin e paraqitur nga denoncuesi është analizuar kohëzgjatja, sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit gjyqësor. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në gjykatën e rrethit gjyqësor.

62.4 Për sa më sipër, duket se nisur nga kohëzgjatja e gjykimit subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42, i Kushtetutës dhe nga neni 6, i KEDNJ-së. Gjithsesi, duhet evidentuar fakti se kemi të bëjmë me një çështje komplekse, pasi janë 6 paditës dhe 15 palë të paditura.

62.5 Vendimet e marra nga gjykatat, lidhur me çështjen objekt ankimi

62.5.1 Trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përbërje të të cilit ka qenë edhe gjyqtari Roland Jaupaj me vendimin e saj nr. ***, datë 15.1.2015 me palë: paditës: H.G., dhe të tjerë; (ii) të paditur: V.Dh., (P) dhe të tjerë; (iii) objekti: ndryshim i aktit administrativ, vendimi nr. ***, datë 13.10.1994, të KKK të Pronave Fier dhe ndryshim i aktit administrativ, vendimi nr. ***, datë 13.10.1994, të KKK të Pronave Fier ka vendosur: rrëzimin e padisë tërësisht për secilin nga paditësit Flamur Begaj dhe të tjerë.

62.5.2 Gjykata e Apelit Vlorë, e përbërë nga trupi gjykues me 3 gjyqtarë, me vendimin nr. ***, datë 6.11.2018, me shumicë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 13.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

62.5.3 Nga verifikimi i faqes zyrtare të web-it të Gjykatës së Lartë konstatohet se për këtë çështje civile është ushtruar rekurs dhe pritet shqyrtimi i saj në këtë gjykatë.

62.5.4 Konstatohet se ndër të tjera kundërshtohet zgjidhja e dhënë nëpërmjet një vendimi gjyqësor të pacenuar nga një gjykatë më e lartë, deri në momentin e trajtimit të ankesës. Si rezultat, edhe në këtë rast, referuar qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. ***, datë 27.5.2004, të sipërcituar, nuk konstatohen shkelje në veprimtarinë e gjyqtarit Roland Jaupaj në dhënien e këtij vendimi gjyqësor në datën 15.1.2015, në çështjen civile me paditës ankuesin, pasi nuk provohen pretendimet e këtij të fundit kundrejt gjyqtarit.

63. Denoncimi nr. *** prot., datë 26.12.2018

⁹² Denoncimi nr. ***, datë 05.01.2018.

63.1 Denoncuesi, z. T.S., denoncon subjektin Roland Jaupaj, se vendimi i marrë prej tij është në zbatim të keq të ligjit procedural dhe atij material, si dhe vetë parimet e zhvillimit të një gjykimi të drejtë, objektiv e të paanshëm.

63.2 Vendimet e marra nga gjykatat lidhur me çështjen objekt ankimi

63.2.1 Trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në përbërje të të cilit ka qenë edhe gjyqtari Roland Jaupaj, me vendimin nr. ***, datë 28.2.2014, me palë: (i) paditës: “****” sh.p.k., Lushnjë; (ii) të paditur: T.S., dhe (iii) objekt: përjashtimin e ortakut T.S., nga shoqëria “****” sh.p.k. ka vendosur: pranimin e padisë; përjashtimin e z. T. S., si ortak në shoqërinë tregtare “****” sh.p.k., duke prishur ortakërinë; si dhe shuarjen e të drejtave të të paditurit T.S., si ortak në shoqërinë tregtare “****” sh.p.k. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në datën 14.11.2013 dhe kjo gjykatë e ka shpallur vendimin në datën 28.2.2014.

63.2.2 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 18.5.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 28.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

63.2.3 Nga verifikimi i faqes zyrtare të web-it të Gjykatës së Lartë konstatohet se për këtë çështje civile është ushtruar rekurs dhe pritët shqyrtimi i saj në këtë gjykatë.

63.3 Edhe në këtë rast konstatohet se kundërshtohet zgjidhja e dhënë nëpërmjet një vendimi gjyqësor të formës të pacenuar nga një gjykatë më e lartë deri në momentin e trajtimit të ankesës. Komisioni vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: *vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit çmohet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si edhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën që vlerësohet.*

63.4 Si rezultat, edhe në këtë rast, referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. ***, datë 27.5.2004, të sipërcituar, nuk konstatohen shkelje në veprimtarinë e gjyqtarit Roland Jaupaj në dhënien e këtij vendimi gjyqësor në datën 28.2.2014, në çështjen civile me palë të paditur ankuesin, pasi nuk provohen pretendimet e këtij të fundit kundrejt gjyqtarit.

64. Subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me gjetjet e konstatuara nga Raporti i KLD-së dhe nga verifikimi i denoncimeve të depozituara pranë Komisionit. Subjekti dërgoi prapësimet⁹³ e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar problematikën mbi këto gjetje, dhe nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional.

65. Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

65.1 Pas shqyrtimit të Raportit të hartuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si edhe denoncimeve të depozituara ndaj këtij subjekti në Komision, si më sipër, trupi

⁹³ Prapësimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 21.5.2019 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2019, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2019.

gjkues nuk gjeti indice apo elemente, që mund të ngrenë dyshime thelbësore për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

65.2 Mbështetur në raportin e Inspektoratit të KLGJ-së dhe shqyrtimin e dy denoncimeve trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

65.3 Për sa në sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

1. Subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
2. Subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
3. Subjekti ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Roland Jaupaj, me detyrë gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 28.5.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA

Anëtare

Pamela QIRKO

Relatore

Gledis HAJDINI

Sekretare gjyqësore